



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 223

Tiranë – E mërkurë, 20 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 722, datë 8.12.2017	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 11873
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 723, datë 8.12.2017	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Hungarisë dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, si dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë, në lidhje me dhënien e mbështetjes së shtetit pritës për kryerjen e operacioneve/stërvitjeve e aktiviteteve ushtarake të ngjashme të NATO-s dhe notës së pranimi për t’u bërë pjesë e saj..... 11873
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 724, datë 8.12.2017	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, si dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë, në lidhje me dhënien e mbështetjes së shtetit pritës për kryerjen e aktiviteteve ushtarake të NATO-s dhe notës së pranimi për t’u bërë pjesë e tij..... 11882
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 725, datë 8.12.2017	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 728, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin e NATO-s “Aegean Sea”, të ndryshuar..... 11890
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 726, datë 8.12.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 910, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak ndërkombëtar “KFOR”, Kosovë”.... 11891

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 727, datë 8.12.2017	Për transferimin e pronës shtetërore sipas hartës treguese, me nomenklaturë k-34-112-127-D, me numër pasurie 402, 403, 404, 405, 406, 410 (numër 19 sipas hartës së kadastrës DAMT), 411 (numër 20 sipas hartës së kadastrës DAMT), 412, 413 e 414, zona kadastrale nr. 2443, Bashkia Fier, njësia administrative Libofshë, dhe të pronës shtetërore sipas hartës treguese, me nomenklaturë k-34-111-(111-D), me numër pasurie 220/1, 220/3, 221/1, 221/3, 224/1, 225/1, 226/1, 227/1, 227/3, 228/1, 228/3, 229/1, 229/3, 230/1, 231/1 e 232/1, zona kadastrale nr. 2085, Karavasta e Re, njësia administrative Remas, Bashkia Divjakë, në fondin e pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike dhe vënien në dispozicion të pasurisë së paluajtshme shtetërore për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik “Albpanel”.....	11891
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 729, datë 8.12.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar.....	11893
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 8.12.2017	Për dhënien e bursave për nxënësit e shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, për vitin shkollor 2017 – 2018.....	11895
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 731, datë 8.12.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 36, datë 16.1.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e anëtarëve të bordit drejtues të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, të ndryshuar.....	11895
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 732, datë 8.12.2017	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 744, datë 5.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin, në përgjegjësi administrimi, të objektit “Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave”, Tiranë, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit/Universiteti Politeknik i Tiranës, te Ministria e Drejtësisë, për Gjykatën e Lartë”.....	11896
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 733, datë 8.12.2017	Për shpalljen e Qendrës Historike të fshatit Theth, Shkodër e të Zonës së Mbrojtur përreth saj dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj.....	11900
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 734, datë 8.12.2017	Për shpalljen e liqeneve të Prespës si zonë bashkëmenaxhuese peshkimi.....	11907
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 735, datë 8.12.2017	Për miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane” truall, të pasurisë me nr. 61/6/6, zona kadastrale 1503, Bashkia Tropojë, të pasurisë me nr. 886, zona kadastrale 1402, Bashkia Dibër, të pasurisë me nr. 792, zona kadastrale 3509, Bashkia Dibër, të pasurive me nr. 36 dhe 66, zona kadastrale 2640, Bashkia Dibër, të pasurisë me nr. 157/13, zona kadastrale 2302, Bashkia Shkodër.....	11907
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 736, datë 8.12.2017	Për disa ndryshime në vendimin nr. 113, datë 17.2.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin, funksionimin, përbërjen dhe përcaktimin e masës së shpërbërimit të anëtarëve të Komitetit Ndërsektorial për Mbrojtjen nga Produktet e Duhanit (KNMSHPD)”.....	11908

**VENDIM**

Nr. 722, datë 8.12.2017

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 513, DATË 13.6.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE,
TË PROCEDURAVE E TË
DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN,
QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË
HUAJVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në aneksin nr. 3, “Lista e vendeve, shtetasit e të cilëve hyjnë pa vizë si rrjedhojë e hyrjes pa vizë në zonën shengen”, që i bashkëlidhet vendimit, shtohen fjalët “Kolumbi” dhe “Peru”, me dokumentin pasaportë.

b) Në aneksin nr. 4, “Lista e vendeve, shtetasit e të cilëve hyjnë me vizë në Republikën e Shqipërisë dhe përfaqësitë ku mund të bëhet aplikimi, si dhe tarifa përkatëse e shërbimit me vizë”, që i bashkëlidhet vendimit, të hiqen fjalët “Kolumbi” dhe “Peru”.

2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 723, datë 8.12.2017

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET QEVERISË SË HUNGARISË
DHE SHTABIT TË KOMANDËS
SUPREME ALEATE PËR
TRANSFORMIMIN, SI DHE SHTABIT
SUPREM TË FUQIVE ALEATE NË
EVROPË, NË LIDHJE ME DHËNIEN E
MBËSHTETJES SË SHTETIT PRITËS
PËR KRYERJEN E OPERACIONEVE/
STËRVITJEVE E AKTIVITETEVE
USHTARAKE TË NGJASHME TË NATO-S
DHE NOTËS SË PRANIMIT
PËR T’U BËRË PJESË E SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Hungarisë dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, si dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë, në lidhje me dhënie e mbështetjes së shtetit pritës për kryerjen e operacioneve/stërvitjeve e aktiviteteve ushtarake të ngjashme të NATO-s dhe notës së pranimit për t’u bërë pjesë e saj, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**



Bashkëlidhje 2 për
SH/SAGLEG/AM/095/16-314597
Datë 8 gusht 16

MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË HUNGARISË
DHE SHTABIT TË KOMANDËS SUPREME
ALEATE PËR TRANSFORMIMIN, SI DHE
SHTABIT SUPREM TË FUQIVE ALEATE NË
EVROPË NË LIDHJE ME DHËNIEN E
MBËSHTETJES SË SHTETIT PRITËS PËR
KRYERJEN E OPERACIONEVE/
STËRVITJEVE DHE AKTIVITETEVE
USHTARAKE TË NGJASHME TË NATO-S

HYRJE

Qeveria e Hungarisë, si dhe Shtabi Suprem i Aleatëve për Transformimin (HQ SACT) dhe Shtabi Suprem i Fuqive Aleatëve në Evropë (SHAPE) më poshtë të referuar si Palët:

Duke pasur parasysh dispozitat e Traktatit të Atlantikut të Veriut të datës 4 prill 1949 dhe veçanërisht nenin 3 të saj;

Duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Palëve në Traktatin Atlantik të Veriut në Lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (PfP SOFA), të datës 19 qershor 1951;

Protokollin mbi Statusin e Shtabit Ndërkombëtar Ushtarak të ngritur në pajtim me Traktatin Atlantik Verior (Protokolli i Parisit), i datës 28 gusht 1952;

Marrëveshjen ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin Atlantik Verior dhe Shteteve të tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (PfP SOFA), të datës 19 qershor 1995;

Protokollin Shtesë të Marrëveshjes ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin Atlantik Verior dhe Shteteve të tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (Protokolli Shtesë i PfP SOFA), i datës 19 qershor 1995;

Dhe duke përfshirë Protokollin tjetër Shtesë të Marrëveshjes ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin Atlantik Verior dhe Shteteve të tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (Protokolli tjetër Shtesë), i datës 19 dhjetor 1997, duke marrë parasysh që Protokolli tjetër Shtesë do të jetë i zbatueshëm kur Hungaria të bëhet Palë në të.

Duke pasur parasysh ligjet e Hungarisë, veçanërisht ligjin XXXIV të vitit 2011 mbi regjistrimin e forcave të armatosura të huaja të pranishme në territorin e Republikës së Hungarisë për qëllime zyrtare dhe të shtabeve ushtarake ndërkombëtare të ngritura në territorin e Republikës së Hungarisë, dhe të personelit të tyre, si dhe mbi dispozitat në lidhje me statusin e tyre ligjor (ligji i Forcave të Ardhura). Kjo do të jetë e zbatueshme deri në momentin e përfundimit të një marrëveshjeje shtesë të plotë dhe të përditësuar sipas protokollit të Parisit të vitit 1952. Pas kësaj, ligji i Forcave të Ardhura do ta plotësojë atë.

Duke pasur parasysh konceptin e angazhimit të forcave të NATO-s dhe forcave të koalicionit nën komandën e NATO-s dhe kontrollit ose nëpërmjet territorit të Hungarisë gjatë periudhave të paqes, krizës, emergjencës dhe konfliktit në mbështetje të operacioneve të NATO-s;

Duke pasur parasysh konceptin e stërvitjeve dhe operacioneve që parashikohen të ndodhin me NATO-n, Partneritetin për Paqe (PfP) dhe forca të tjera të udhëhequra nga NATO;

Dhe duke marrë parasysh nevojat e Hungarisë, që më poshtë quhet Shteti Pritës, dhe nevojat e Komandës Aleate për Operacionet (ACO) dhe Komandës Aleate për Transformimin (ACT), më poshtë referuar si Komanda Strategjike (SCs);

PJESËMARRËSIT KANË ARRITUR MIRË-KUPTIMIN E MËPOSHTËM:

SEKSIONI I PARË

1. PËRKUFIZIME

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve mbështetëse zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1.1 Forcat – Të gjithë komponentët e forcës së udhëhequr nga NATO-ja, që përfshin të gjithë personelin, kafshët, materialet dhe rezervat, së bashku me çdo komponent tjetër civil të këtyre forcave, siç përkufizohen te NATO SOFA, Protokolli i Parisit dhe PfP ose shtete të tjera që marrin pjesë nën udhëheqjen e NATO-s. Termi përfshin gjithashtu të gjitha anijet, avionët, automjetet, magazinat, pajisjet dhe municionin, si dhe burimet e lëvizjes në ajër, tokë dhe det.

1.2 Aktivitetet Ushtarake të NATO-s – Veprimet ushtarake, duke përfshirë stërvitjen, eksperimentimin operacional dhe aktivitete të ngjashme ose kryerjen e misioneve ushtarake



strategjike, taktike, të shërbimit, trajnuese ose administrative të kryera nga forcat; procesi i zhvillimit të luftimit, duke përfshirë sulmin, lëvizjen, furnizimin dhe manovrat që nevojiten për të arritur objektivat e çdo lufte ose fushate.

1.3 Komandant i NATO-s – Një komandant ushtarak në zinxhirin e komandës së NATO-s.

1.4 Organizatat e NATO-s – Komandat ose repartet e organizuara të forcave nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.5 Komanda Ushtarake Ndërkombëtare – Komanda Ushtarake Ndërkombëtare në strukturat e integruara të komandës së NATO-s ose që u është dhënë statusi nga NAC/DPC. Përfshin aktivitetet që mund të jenë detashmente të përkohshme ose njësi të Komandave.

1.6 Komanda Kombëtare – Komandat e forcave kombëtare nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.7 Komanda Shumëkombëshe – Komanda me personel nga më shumë se një shtet që formohen me marrëveshjen e shteteve pjesëmarrëse dhe nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.8 Shtete Dërguese (SNs) – Ato shtete dhe Komanda ose elementët e tyre që angazhohen në territorin e HN-së në mbështetje të operacioneve të NATO-s.

1.9 Shteti Pritës (HN) – Hungaria.

1.10 Komanda ose Komandantët Strategjikë (SCs) – Komandanti Suprem i Aleatëve në Evropë (SACEUR), komandanti i Shtabit Aleat për Operacionet (ACO) dhe Shtabit Suprem Aleat për Transformimin (SACT), Komandanti i Shtabit Aleat për Transformimin (ACT).

1.11 Mbështetja e Shtetit Pritës (HNS) – Asistenca civile dhe ushtarake që u jepet në kohë paqeje, emergjence, krize, konflikti nga një Shtet Pritës forcave dhe organizatave aleate që ndodhen, operojnë ose kalojnë tranzit përmes territorit, ujërave territoriale ose hapësirës ajrore të Shtetit Pritës.

1.12 Mbrojtja e Forcës (FP) – Të gjitha masat e marra dhe mjetet që përdoren për të minimizuar vulnerabilitetin e personelit, mjediseve, pajisjeve dhe operacioneve ndaj çdo rreziku në të gjitha situatat, për të ruajtur lirinë e veprimit dhe efektivitetin operacional të forcës.

1.13 Shpenzimet – Ato shpenzime që shoqërohen me ngritjen, mbështetjen dhe mbajtjen e komandave, forcave kombëtare, shumëkombëshe

ose ndërkombëtare ose të formacioneve të NATO-s. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve të saj mbështetëse:

a) Shpenzimet e Zakonshme të NATO-s – Ato shpenzime për të cilat bihet dakord paraprakisht të jenë përgjegjësi e përbashkët e Aleancës.

b) Shpenzime të Përbashkëta – Ato shpenzime për të cilat bihet dakord paraprakisht të jenë përgjegjësi e përbashkët e më shumë se një shteti. Masat e Shpenzimeve të Përbashkëta bazohen zakonisht në një formulë të detajuar në Marrëveshjen Teknike përkatëse dhe/ose Marrëveshjet e Përbashkëta të Zbatimit.

c) Shpenzime të Drejtpërdrejta Kombëtare – Ato shpenzime që konsiderohen të jenë përgjegjësi e një SN-je të vetëm.

1.14 Financim i Përbashkët i NATO-s – Fondet e dhëna nga shtetet e NATO-s dhe që ofrohen me miratimin nëpërmjet buxheteve të NATO-s për shpenzimet e zakonshme që shkaktohen gjatë zhvillimit të aktiviteteve ushtarake të NATO-s të specifikuara në të.

1.15 Notë Pranimi (NOA). Një dokument që tregon synimin e një SN-je për të marrë pjesë në masat për HNS-në sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje për një operacion të specifikuar të drejtuar nga NATO.

1.16 Deklaratë Synimi (SOI) – Një dokument që tregon një synim të një SN-je për të marrë pjesë në masat për HNS-në sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, por duke iu nënshtruar rezervave të caktuara specifike. HN-ja konfirmon nëse rezervat janë të pranueshme apo jo për dhënien e HNS-së.

1.17 Marrëveshje Teknike (TA) – Një marrëveshje pasuese dypalëshe për një operacion të caktuar të drejtuar nga NATO. Ajo detajon përgjegjësitë dhe procedurat për dispozitat e HNS-së nga HN-ja ndaj Komandantit të NATO-së dhe SN(ve).

1.18 Marrëveshje e Përbashkët Zbatimi (JIA) – Një marrëveshje pasuese dypalëshe që vendos angazhimin ndërmjet palëve nënshkruese në lidhje me dhënien dhe marrjen e HNS-së. Kjo përfshin informacionin e hollësishëm për mbështetjen e kërkuar dhe të ofruar, procedurat e specifikuara të vendit për zbatimin dhe rimbursimin ose kushtet e pagesës.

1.19 Komiteti Drejtues i Mbështetjes së Përbashkët të Shtetit Pritës (JHNSSC) – Një komitet i ngritur në mënyrë të posaçme dhe i



bashkëkryesuar nga HN-ja dhe Komandanti i NATO-s. Komiteti, i përbërë nga përfaqësuesit e autorizuar nga të gjithë SN-të, HN-ja dhe Komandanti i NATO-s takohen për të zhvilluar masat e nevojshme përforcuese në lidhje me HNS-në, si TA-ja dhe JIA(të), sipas rastit.

1.20 Vendet Operacionale – Vendet që ndodhen në territorin e HN-së për qëllimin e mbështetjes operacionale dhe/ose logjistike për forcën për operacionet e drejtuara nga NATO. Këto vende janë detashmente të një komande strategjike nën komandën e Komandanit të NATO-s.

1.21 Kontraktuesit e NATO-s – Bizneset, subjektet juridike dhe personat fizikë që kontraktohen nga NATO, shtetet anëtare të NATO-s dhe shtetet jopjesëtare në NATO, që kontribuojnë në operacionet e drejtuara nga NATO dhe që ofrojnë mallra dhe/ose shërbime të çdo natyre në territorin e Hungarisë për NATO-n në kuadrin e operacioneve, stërvitjeve ose aktiviteteve ushtarake të drejtuara nga NATO. Kjo përfshin të punësuarit nga kontraktuesit, si dhe nënkontraktuesit dhe të punësuarit e tyre që veprojnë në kuadrin e operacionit. Përdorimi i kontraktuesve të NATO-s do t'i nënshtrohet masave të veçanta.

1.22 Përveç kur një kuptim specifikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, zbatohet Fjalori i NATO-s për Termat dhe Përkufizimet (AAP-6).

SEKSIONI I DYTË

2. QËLLIMI

2.1 Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është krijimi i politikës dhe procedurave për përcaktimin e vendeve operacionale dhe ofrimin e HNS-së të forcat e NATO-s ose të mbështetur nga HN-ja gjatë aktiviteteve ushtarake të NATO-s.

2.2 Kjo Marrëveshje dhe dokumentet e saj pasuese synohet të shërbejnë si bazë për planifikimin nga autoriteti përkatës i HN-së dhe nga Komandantët e NATO-s, duke parashikuar masat e HNS-së për një sërë aktiviteteve ushtarake të NATO-s. Këto misione përfshijnë ato për të cilat janë identifikuar forcat e angazhuara dhe ato për të cilat duhet të identifikohen forcat.

SEKSIONI I TRETË

3. OBJEKTI DHE MASA TË PËRGJITHSHME

3.1 Dispozitat e NATO-s ose Pfp SOFA, Protokollit të Parisit dhe Protokollit tjetër Shtesë dhe çdo marrëveshjeje tjetër përkatëse që mund të jenë në fuqi ndërmjet SC-ve dhe HN-së zbatohen për të gjitha aktivitetet ushtarake të NATO-s.

3.2 HN-ja njeh vendet operacionale të ngritura sipas kësaj Marrëveshjeje si detashmente të SC-së krijuese dhe aktivitetet e këtyre detashmenteve si sipërmarrje të SC-së. Vendet që duhet të vendosen, identifikohen në dokumente pasuese. Masat e komandës dhe kontrollit do të caktohen në planet përkatëse operacionale ose planet e stërvitjes.

3.3 Kjo Marrëveshje synon të jetë në pajtim me doktrinën dhe politikën e NATO-s dhe ofron një masë dhe strukturë ombrellë për HNS-në. Doktrinën dhe politikën përkatëse të NATO-s janë të zbatueshme duke iu nënshtuar rezervave ose deklarimeve të bëra nga HN-ja në lidhje me këto doktrina dhe politika.

3.4 HN-ja do të japë mbështetje brenda kapacitetit të tij të plotë, duke iu nënshtuar disponibilitetit dhe brenda kufizimeve praktike të rrethanave që ekzistojnë për momentin, për forcat e dislokuara në aktivitetet ushtarake të NATO-s. Hollësitë e kësaj mbështetjeje do të trajtohen në dokumente shtesë.

3.5 Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen në kohë paqeje, emergjence, krize dhe konflikti ose periudha të tensionit ndërkombëtar, siç mund të përcaktohet reciprokisht nga HN-ja dhe Autoritetet e NATO-s.

3.6 Ndërsa SN-të dërguese inkurajohen të marrin pjesë në operacionet e NATO-s dhe të pranojnë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, si një dokument ombrellë sipas të cilit HNS-ja jepet nga HN-ja, marrëveshjet e veçanta bilaterale me shtetet individuale mund të merren parasysh nga HN-ja rast pas rasti.

3.7 HN-ja dhe SC-të mund të caktojnë përfaqësues për të negociuar dokumentet që mbështesin dhe zhvillojnë më tej këtë Marrëveshje.

3.8 Aktivitetet ushtarake të drejtuara nga NATO të mbështetura nga kjo Marrëveshje mund të kërkojnë operacione të mbështetjes shumëkombëshe me avionë dhe helikopterë, dhe në rastin e porteve, me anije mbështetëse ushtarake



dhe mallrash. HN-ja pranon që lëvizja e këtyre avionëve, helikopterëve, anijeve dhe ekuipazhit të tyre në dhe përmes zonave territoriale të HN-së do të bëhet në bazë të një lejeje të përgjithshme për kohëzgjatjen e aktivitetit ushtarak të NATO-s.

3.9 Leja e përgjithshme apo leja tjetër për hyrjen, transitin dhe daljen e Forcave në, përmes dhe nga territori i HN-së lëshohet duke iu nënshtruar pëlqimit dhe procedurave administrative të HN-së.

SEKSIONI I KATËRT

4. PËRGJEGJËSITË

Brenda kuadrit të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje

4.1 Shteti Pritës

a) Gjatë zhvillimit të dokumenteve mbështetëse dhe me ndodhjen e ndryshimeve dhe pas përfundimit të këtyre dokumenteve, HN-ja bën njoftim në kohën e duhur për Komandantin e NATO-s në lidhje me disponibilitetin ose ndonjë mangësi të aftësive të HNS-së. HN-ja merr parasysh që planifikuesit e NATO-s bazohen te dokumentet mbështetëse të përgatitura për këtë Marrëveshje dhe kërkojnë një njoftim në kohë për ndryshimet e planifikuara për strukturat dhe aftësitë kombëtare.

b) Me qëllim që të jepet mbështetje, HN-ja merr masat e nevojshme për burimet e mbështetjes për të përfshirë burimet civile dhe tregtare. Mbështetja e siguruar me prokurim sigurohet nëpërmjet një procesi ofertimi konkurrues në pajtim me rregulloret e brendshme për prokurimet.

c) HN-ja mban regjistrat administrative dhe financiare të nevojshëm për të realizuar rimbursimin e HN-së për burimet e dhëna për forcat. Regjistrat që dokumentojnë transaksionet e financuara nga buxheti i NATO-s ofrohen për NATO-n, siç kërkohej nga qëllimet e auditimit.

d) Standardet e mallrave dhe shërbimeve të dhëna nga HN-ja do të jenë në pajtim me hollësitë e përcaktuara në dokumentet mbështetëse.

e) HN-ja do të ruajë kontrollin mbi burimet e veta të HNS-së, përveç kur kontrolli i këtyre burimeve është lënë i lirë.

f) HN-ja do të ofrojë, para çdo aktivitetet ushtarake të NATO-s, një listë çmimesh për çdo mbështetje përkatëse ose të identifikuar të HN-së.

g) HN-ja do të ftojë SN-të të pranojnë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet një Note Pranimi ose Deklarimi Synimi.

h) HN-ja (në bashkërendim me Komandantin e NATO-s) i jep forcës mbështetje mjekësore dhe dentare nga personeli/mjediset ushtarake të HN-së sipas të njëjta kushteve që u jep ushtarakëve të HN-së.

i) HN-ja parashikon procedurat për lidhjet mjekësore ndërmjet HN-së dhe SN-së, duke përfshirë POC-të mjekësore.

j) Gjatë përgatitjes së dokumenteve mbështetëse dhe pasuese, HN-ja do t'i japë Komandantit të NATO-s kopje të çdo rregulloreje shëndetësore, sigurie dhe mjedisore dhe bujqësore, që mund të zbatohet për operacionin e NATO-s, si dhe çdo rregulloreje në lidhje me ruajtjen, zhvendosjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme dhe municioneve.

k) HN-ja pranon që kopjet e listës së mallrave të SN-së për pajisjet dhe furnizimet për përdorim ushtarak dhe personal në pajtim me NATO SOFA do të jenë dokumentacion i mjaftueshëm për qëllimet doganore.

4.2 Komandanti i NATO-s

a) Komandanti i NATO-s garanton, në masën maksimale të mundshme, që dokumentet mbështetëse të specifikojnë tipin, sasinë dhe cilësinë e mbështetjes së kërkuar. Vihet re që struktura e misionit dhe forcës që përcaktohet për një Plan Operacional (OPLAN), një Urdhër Operacional (OPORD) ose një Urdhër Operacional Stërvitor (EXOPORD) nuk mund të specifikohet para kohe. Komandanti i NATO-s jep informacionin e nevojshëm shtesë për planifikimin e HN-së sa më shpejt të jetë e mundur.

b) Komandanti i NATO-s i dërgon HN-së njoftim në kohë në lidhje me çdo ndryshim të rrethanave dhe propozon ndryshimin e dokumenteve mbështetëse dhe pasuese, sipas rastit.

c) Komandanti i NATO-s përcakton nëse ofrohet financimi i zakonshëm dhe cilat kërkesa janë të përshtatshme për financim të zakonshëm.

d) Komandanti i NATO-s përcakton dhe vendos prioritetet e kërkuara të HNS-së dhe aprovon çmimet në lidhje me shpenzimet e zakonshme.

e) Komandanti i NATO-s garanton rimbursimin financiar për HN-në për HNS-të e rëna dakord, nëse paguhet nga financimi i



zakonshëm. Në të gjitha rastet e tjera, Komandanti i NATO-s ndihmon në masën që është e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve financiare ndërmjet HN-së dhe SN-ve.

f) Nëse kërkesat e SN-ve janë në konflikt me prioritetet e Komandantit të NATO-s për shpërndarjen e burimeve, Komandanti përkatës i NATO-s e zgjidh konfliktin me SN-të e përfshira.

g) Komandanti i NATO-s identifikon personelin dhe kërkesat e tjera për operacionin e vendeve që caktohen në HN.

h) Komandanti i NATO-s do të lehtësojë standardizimin e kërkesave dhe kostos së mbështetjes gjatë negociatave dhe/ose tek JHNSSC-ja.

4.3 Shtetet Dërguese

a) SN-të mund të zgjedhin të marrin pjesë në strukturën dhe procedurat për HNS-në duke pranuar dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet një NOA-je ose duke nxjerrë një SOI për një operacion të caktuar të NATO-s.

b) SN-të identifikojnë kërkesat e HNS-s ndaj HN-së dhe Komandantit përkatës të NATO-s.

c) Për kërkesat e Kostos së Drejtpërdrejtë Kombëtare, SN-ja normalisht merr pjesë në negociatat për HNS-të gjatë JHNSSC-së ose drejtpërdrejt me HN-në, nëse nuk krijohet një JHNSSC. SN-të ofrojnë pagesën e drejtpërdrejtë ose rimbursimin për HNS-të ndaj HN-së vetëm për shërbimet e dhëna nga burimet ushtarake, përveç kur përdoren, siç është rënë dakord, procedura të tjera pagese. Sipas masave kontraktuale të marra nga HN-ja dhe SN-të, mbështetja e dhënë nga burimet tregtare ose civile do të paguhet drejtpërdrejt nga SN-të.

d) SN-të do të ofrojnë personel të autorizuar për të marrë pjesë në diskutimet e HNS-së gjatë JHNSSC-së, nëse krijohet.

e) SN-të do të raportojnë ndryshimet e kërkesave të HNS-së tek HN-ja dhe Komandanti përkatës i NATO-s kur ato kryhen dhe paraqet kërkesat e rishikuara dhe/ose situacionet.

f) SN-të janë përgjegjëse për shpenzimet e çdo shërbimi mjekësor ose dentar të dhënë nga HN-ja.

g) SN-të duhet të respektojnë rregulloret dhe procedurat e HN-së për shëndetin, sigurinë, mjedisin dhe bujqësinë që janë identifikuar për vendet operationale, si dhe çdo rregullore të HN-së për ruajtjen, zhvendosjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme.

SEKSIONI I PESTË

5. MASA FINANCIARE

5.1.1 Sipas rastit, me marrëveshje të ndërsjellë dhe/ose konventa ndërkombëtare, aktivitetet e Komandave Ushtarake Ndërkombëtare, vendet operationale, anijet, avionët, dhe automjetet në pronësi dhe/ose të kontraktuara nga NATO, dhe karburanti, vajrat dhe lubrifikantët (POL) dhënë forcave të NATO-s janë të përjashtuara nga doganat, tatimet, detyrimet, akcizat, pagesat shtetërore, tarifat dhe të gjitha pagesat e ngjashme, në pajtim me traktatet rregulluese të NATO-s.

5.1.2 Asgjë në këtë Marrëveshje nuk kuptohet sikur ofron privilegje financiare për anëtarët individualë të forcave.

5.1.3 Me qëllim që të parandalohet abuzimi me privilegjet, HN-ja mund të kërkojë që kushti administrativ për forcën për çdo privilegj financiar të jetë regjistrimi sipas ligjeve të HN-së duke pasur parasysh ligjin e Forcave të Ardhura. Kjo nuk i kufizon të drejtat financiare të dhëna forcës nga traktatet rregulluese të NATO-s.

5.2 Protokollin e Parisit, Protokollin tjetër Shtesë që zbaton imunitetet dhe privilegjet në lidhje me Komandat Ushtarake Ndërkombëtare do të zbatohen për çdo element të shtabit, detashment që mund të dislokohet në HN sipas zbatimit të një aktiviteti ushtarak të NATO-s. Në lidhje me ato Shtete Dërguese, shtetet përkatëse të cilave nuk janë Palë në Protokollin e Parisit, përveç Shteteve Anëtare të NATO-s, HN-ja do të zbatojë Protokollin e Parisit sipas kësaj Marrëveshjeje me kusht që ato Shtete Dërguese të deklarojnë në një deklaratë me shkrim të nivelit qeveritar që ato iu nënshtrohen dispozitave të Protokollit të Parisit në territorin e HN-së.

5.3.1 Pajisjet, furnizimet, produktet e vendosura nën një procedurë të përkohshme importimi në territorin e HN-së ose të eksportuara nga territori i HN-së në lidhje me një aktivitet ushtarak të NATO-s, janë të përjashtuara nga të gjitha taksat doganoret, tatimet dhe tarifat. Procedurat doganore do të përcaktohen në pajtim me NATO-n ose PfP SOFA, Protokollin e Parisit dhe Protokollin tjetër Shtesë, sipas rastit.

5.3.2 Shërbimet e importuara dhe të eksportuara nga territori i HN-së në lidhje me një aktivitet ushtarak të NATO-s përjashtohen nga të gjitha tatimet dhe tarifat.



5.4 Nëse përjashtimi i plotë nga tatimet, detyrimet, tarifat ose pagesat e ngjashme nuk është e mundur për blerjet e kryera nga ekonomia vendëse e HN-së, detyrimet nuk vendosen në një nivel më të lartë se ajo që zbatohet për Forcat e Armatosura të HN-së. Të gjitha shpenzimet duhet të përpunohen me shumën më të vogël që shoqëron kërkesat administrative.

5.5 Transaksionet financiare të forcave në lidhje me aktivitetet ushtarake të NATO-s që përfshijnë transferimin e fondeve dhe krijimin e llogarive në çdo institucion bankar privat ose qeveritar duhet të kryhen pa marrë asnjë pagesë apo tarifë të asnjë lloji që janë parashikuar në ligjin e HN-së.

5.6 Masat përfundimtare financiare, veçanërisht ato në lidhje me financimin e zakonshëm të NATO-s, do të vendosen vetëm para zbatimit të Operacionit të NATO-s. Të gjitha masat financiare që negociohen paraprakisht duhet të jenë specifike në lidhje me detyrimet financiare maksimale të NATO-s. Shpenzimet për të cilat nuk bihet specifikisht dakord që të jenë shpenzime të financuara nga NATO, para se të realizohen shpenzimet, nuk marrin financim të zakonshëm nga NATO.

5.7 Dokumentet pasuese ofrojnë bazën fillestare për vlerësimet e shpenzimeve dhe shërbejnë si bazë për kategorizimin e shpenzimeve si Shpenzime të Zakonshme të NATO-s (sipas rastit), Shpenzime të Përbashkëta ose Shpenzime të Drejtpërdrejta Kombëtare.

5.8 Nëse Komandanti i NATO-s përcakton që disa shpenzime janë të përshtatshme dhe të përballueshme nga financimi i zakonshëm i NATO-s (nga alokimet e aprovuara të buxhetit), SC-ja autorizon financimin e zakonshëm për ato shpenzime dhe i paguan drejtpërdrejt ose rimbursion HN-në.

5.9 Nëse shpenzime të caktuara përcaktohen t'i takojnë më shumë se një shteti, këto shpenzime mund të identifikohen si shpenzime të përbashkëta dhe, nëpërmjet marrëveshjes së përbashkët të shteteve të përfshira, mund të ndahen në pajtim me formulën e ndarjes së shpenzimeve të aprovuara në TA ose dokumente të tjera mbështetëse.

5.10 Detyrimet për materialet dhe shërbimet civile dhe ushtarake të dhëna nga HN-ja nuk vendosen me një normë më të lartë se ato që u ngarkohen Forcave të Armatosura të HN-së, dhe nuk përfshijnë shpenzime të tepërta administrative

ose të tjera, por mund të reflektojnë përshtatje për shkak të grafikëve të dorëzimit, pikave të dorëzimit ose faktorëve të ngjashëm. Rimbursimi nuk paguhet për mbështetjen e dhënë nga personeli ushtarak.

5.11 Komandanti i NATO-s dhe SN-të mund të kontraktojnë drejtpërdrejt me furnizuesit tregtarë për furnizime, shërbime ose mbështetje tjetër.

5.12 Automjetet në pronësi të NATO-s dhe automjetet ushtarake të SN-së janë të vetësiguruara dhe, si të tilla, mund të operojnë pa siguracion tregtar, kështu NATO, SC-të dhe SN-të janë drejtpërdrejt përgjegjës për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga ose në lidhje me automjetet e tyre, për të cilat ata janë të detyruar të bëjnë kompensimin.

5.13 HN-ja nuk shkakton asnjë detyrim financiar në emër të Komandantit të NATO-s ose SN-së, përveç kur i kërkohet specifikisht ta bëjë këtë paraprakisht nga një përfaqësues i autorizuar dhe përveç kur është rënë dakord për përgjegjësinë për pagesën e shpenzimeve. Për më tepër, asnjë fond nuk jepet para se SC(të) ose SN(të), sipas rastit, të kenë aprovuar dokumentet përkatëse mbështetëse dhe të kenë udhëzuar zbatimin e tyre.

5.14 Nuk është dhënë financim në lidhje me këtë Marrëveshje dhe ky dokument nuk përfaqëson ndonjë detyrim specifik financimi nga ana e Komandantit të NATO-s ose SN-ve. Masat e hollësishme financiare dhe procedurat e rimbursimit do të specifikohen në dokumentet mbështetëse.

5.15 Caktimi i vendeve operationale në mbështetje të një operacioni të NATO-s nuk parashikon ndërtim ose rehabilitim infrastrukture.

5.16 Në lidhje me Kontraktuesit e NATO-s, me qëllim që të lehtësohet dislokimi i tyre pa pengesa të forca dhe aktiviteti i tyre në territorin e HN-së, sipas rastit, HN-ja do të bëjë çdo përpjekje për të zbutur procedurat administrative dhe financiare dhe për të përjashtuar ato nga detyrimet financiare në masën maksimale të mundshme, duke marrë parasysh traktatet rregulluese të NATO-s.

SEKSIONI I GJASHTË

6. KONSIDERATA JURIDIKE

6.1 SC-të do të kryejnë, ose mund të delegojnë, veprimet juridike që janë thelbësore për përmbushjen e misionëve, duke përfshirë, por pa u kufizuar në ushtrimin e kapacitetit për të lidhur



kontrata, angazhuar në procedura ligjore ose administrative, dhe të përftojnë dhe disponojnë mbi pronën.

6.2 Statusi i forcave të angazhuara në territorin e HN-së do të përcaktohet në pajtim me NATO-n ose Pfp SOFA, Protokollin e Parisit dhe Protokollin Tjetër Shtesë, si dhe në çdo marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe ku HN-ja është palë që zbaton këto marrëveshje.

6.3 Në lidhje me ato Shtete Dërguese, shtetet përkatëse të cilave nuk janë Palë në marrëveshjet e përmendura në paragrafin 6.2, HN-ja do të zbatojë këto marrëveshje me kushtin që ato Shtete Dërguese të deklarojnë në një deklaratë me shkrim në nivel qeveritar që ato do t'u nënshtrohen dispozitave të atyre marrëveshjeve në territorin e HN-së.

6.4 Pretendimet jokontraktuale që rrjedhin ose janë në lidhje me ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje trajtohen në pajtim me dispozitat e NATO-s ose Pfp SOFA.

6.5 Pretendimet kontraktuale trajtohen dhe gjykohen në pajtim me kushtet e kontratave. HN-ja ndihmon nëse është e nevojshme.

SEKSIONI I SHTATË

7. MBROJTJA E FORCËS

7.1 FP-ja e plotë dhe efektive planifikohet për Komandën statike të NATO-s dhe të gjitha aktivitetet ushtarake të ngjashme dhe detajohet në OPLANS, EXPI ose masat pasuese, sipas rastit. FP-ja zbatohet në pajtim me politikën dhe procedurat e NATO-s dhe në një mënyrë që është në pajtim me NATO / Pfp SOFA. FP-ja nuk kërkohet në asnjë rrethanë të jetë në kundërshtim me NATO Pfp SOFA ose ligjet e HN-së.

7.2 Sipas rastit, HN-ja do të informojë SN-në dhe Komandantin e NATO-s për masat dhe kufizimet e propozuara për FP-në.

7.3 Sipas rastit, çdo SN është përgjegjës për identifikimin dhe parashikimin e kërkesave dhe kufizimeve të FP-së tek HN-ja dhe Komandanti i NATO-s.

7.4 Përveç këtyre përgjegjësive të FP-së të detajuara në politikën dhe procedurat e NATO-s për FP-në, Komandanti i NATO-s është përgjegjës për bashkërendimin e të gjithë elementëve të kërkuar dhe të paraqitur për HN dhe SN FP-në, sipas rastit, për mbrojtjen e Forcës së tij.

SEKSIONI I TETË

8. SIGURIA DHE DEKLARIMI I INFORMACIONIT

8.1 Ndërmjet shteteve anëtare të NATO-s, informacioni i klasifikuar i ruajtur, trajtuar, gjeneruar, transmetuar ose shkëmbyer si rezultat i ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje trajtohet në pajtim me C-M (2002) 49, "Siguria brenda Organizatës së Traktatit Atlantik Verior", të datës 17 qershor 2002, në botimin e autorizuar përkatës, duke përfshirë të gjitha shtojcat dhe ndryshimet në të dhe në marrëveshjet dhe masat ekzistuese për sigurinë.

8.2 Informacioni i dhënë nga një pjesëmarrës ose SN një tjetri në mirëbesim dhe çdo informacion i tillë i nxjerrë nga një pjesëmarrës ose SN, i cili kërkon konfidencialitet, ruan klasifikimin e tij origjinal ose i caktohet një klasifikim që garanton një shkallë të mbrojtjes ndaj deklaramit, të barabartë me atë që kërkohet nga pjesëmarrësi ose SN-ja.

8.3 Çdo pjesëmarrës dhe SN ndërmerr të gjitha hapat e ligjshëm të mundshëm për moszbulimin e të gjithë informacionit të shkëmbyer në mirëbesim, përveç kur pjesëmarrësit ose SN-të bien dakord për këtë deklaramit.

8.4 Për të ndihmuar në dhënien e mbrojtjes së dëshiruar, çdo pjesëmarrës ose SN e shënon këtë informacion të dhënë tjetrit në mirëbesim me një legjendë, që tregon origjinën, klasifikimin e sigurisë dhe kushtet e tij të deklaramit, që informacioni lidhet me një operacion të NATO-s dhe që është dhënë në mirëbesim.

8.5 Vizitat nga personeli do të rregullohen në pajtim me procedurat e specifikuar në C-M (2002) 49, i ndryshuar.

8.6 I gjithë informacioni i klasifikuar që i nënshtrohet dispozitave të këtij seksioni do të vazhdojë të mbrohet në rastin e tërheqjes së një pjesëmarrësi ose pas prishjes së kësaj Marrëveshjeje.

SEKSIONI I NËNTË

9. HYRJA NË FUQI, KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI

9.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e tridhjetë (30-të) pas datës së njoftimit nga Qeveria e Hungarisë që procedura e brendshme e nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje është



përfunduar rregullisht dhe mbetet në fuqi përveç kur një prej Palëve e prish atë, duke bërë një njoftim paraprak gjashtëmujor me shkrim drejtuar të gjithë pjesëmarrësve të tjerë.

9.2 Të gjitha dispozitat e seksioneve 5, 6 dhe 8 mbeten në fuqi në rastin e tërheqjes së një pjesëmarrësi ose të prishjes së kësaj Marrëveshjeje deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve. SN-të përmbushin të gjitha detyrimet në rastin e prishjes apo tërheqjes.

SEKSIONI I DHJETË

10. NDRYSHIMI DHE INTERPRETIMI

10.1 Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet ose modifikohet me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të të gjithë pjesëmarrësve.

10.2 Konfliktet e dukshme në interpretimin dhe zbatimin e këtij Marrëveshjeje zgjidhen me konsultime ndërmjet Palëve në nivelin më të ulët të mundshëm dhe nuk i referohen asnjë gjykatë kombëtare ose ndërkombëtare apo pale të tretë për zgjidhje.

10.3 Kjo Marrëveshje është nënshkruar në tri kopje, ku secila përmban tekstin në gjuhën angleze dhe hungareze.

10.4 Problemet e përkthimit dhe interpretimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen sipas versionit të gjuhës angleze.

Sa më sipër përfaqëson marrëveshjet e arritura ndërmjet Qeverisë së Hungarisë dhe Komandave, Komandës Supreme të Fuqive Aleate për Transformimin, si dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropë, për çështjet e referuara në të.

NËNSHKRUAR:

Për Qeverinë e Hungarisë

(Vula dhe nënshkrimi)

Gjeneral Lejtnant Zoltan Orosz Ph.D

Zëvendëseshëf i Mbrojtjes

Forcat Hungareze të Mbrojtjes

Datë 30 qershor 2016

Budapest, Hungari

Emri

Titulli/Grada

Datë 2 maj 2006

Në emër të Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropë

dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin

(Nënshkrimi)

Werner Freers

Emri

Gjeneral, Ushtria DEU

Shef Shtabi

Datë 5 korrik 2016

Mons, Belgjikë

NOTË PRANIMI

PËR PJESËMARRJE NË MBËSHTETJEN E SHTETIT PRITËS DHE PËRGJEGJËSITË FINANCIARE DHE TË TJERA TË CAKTUARA BRENDA HUNGARISË (HOST NATION) PËR OPERACIONET/ STËRVITJET

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (SN), i përfaqësuar nga ALB NMR në SHAPE, Kapiten (N) Adnand Agastra,

pasi ka vendosur që Forcat e tij të Armatosura do të marrin pjesë në stërvitjet dhe/ose operacionet në lidhje me aktivitetet në kontekstin e planit të veprimit të gatishmërisë së aprovuar nga Këshilli Atlantik Verior;

duke marrë parasysh konceptin e përgjithshëm të Operacionit/Stërvitjes së NATO-s brenda doktrinës së NATO-s, dhe

me dëshirën për të marrë pjesë në masat në lidhje me mbështetjen e shtetit pritës dhe përgjegjësitë financiare dhe të tjera të Hungarisë, Komanda Supreme e Fuqive Aleate në Europë (SHAPE) dhe Shtabi i Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) dhe shtetet e tjera dërguese në lidhje me mbështetjen e këtyre forcave të armatosura gjatë stërvitjeve dhe operacioneve në lidhje me aktivitetet në kontekstin e Planit të Veprimit të Gatishmërisë;

zgjedh të marrë pjesë dhe të respektojë dispozitat e përfshira në:

“Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Hungarisë dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin dhe Komandës Supreme e Fuqive Aleate në Europë në lidhje me dhënien e mbështetjes së shtetit pritës për ekzekutimin e operacioneve, stërvitjeve dhe aktivitetëve të



ngjashme ushtarake të NATO-s, që ka hyrë në fuqi në 8 shkurt 2017:

Si Shtet Dërgues për aktivitetet ushtarake në lidhje me ndërmarrjet në kontekstin e Planit të Veprimit të Gatishmërisë nëpërmjet MOU-së së përmendur më sipër.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës
së Shqipërisë
ALB NMR në SHAPE, Kapiten (N) Adnand
Agastra

Datë 13.10.2017

VENDIM
Nr. 724, datë 8.12.2017

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT
TË MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
KROACISË DHE SHTABIT TË
KOMANDËS SUPREME ALEATE PËR
TRANSFORMIMIN, SI DHE SHTABIT
SUPREM TË FUQIVE ALEATE NË
EVROPË, NË LIDHJE ME DHËNIEN
E MBËSHTETJES SË SHTETIT PRITËS
PËR KRYERJEN E AKTIVITETEVE
USHTARAKE TË NATO-S DHE NOTËS
SË PRANIMIT PËR T’U BËRË PJESË
E TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, si dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë, në lidhje me dhënie e mbështetjes së shtetit pritës për kryerjen e aktiviteteve ushtarake të NATO-s dhe notës së pranimit për t’u bërë pjesë e tij, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS
SË KROACISË DHE SHTABIT TË
KOMANDËS SUPREME ALEATE PËR
TRANSFORMIMIN, SI DHE SHTABIT
SUPREM TË FUQIVE ALEATE NË EVROPË
NË LIDHJE ME DHËNIEN E
MBËSHTETJES SË SHTETIT PRITËS
PËR KRYERJEN E AKTIVITETEVE
USHTARAKE TË NATO-S**

PREAMBULË

Qeveria e Republikës së Kroacisë, si dhe Shtabi i Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT), si dhe Shtabi Suprem i Fuqive të Aleatëve në Evropë (SHAPE) më poshtë të referuar si “Palët”:

duke pasur parasysh dispozitat e Traktatit të Atlantikut të Veriut të datës 4 prill 1949 dhe veçanërisht menin 3 të tij;

duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Palëve në Traktatin Atlantik të Veriut në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (PfP SOFA), të datës 19 qershor 1951, Protokollin mbi Statusin e Shtabit Ndërkombëtar Ushtarak, të ngritur në pajtim me Traktatin Atlantik Verior (Protokolli i Parisit), i datës 28 gusht 1952, Marrëveshjen ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin Atlantik Verior dhe Shteteve të tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (PfP SOFA), të datës 19 qershor 1995, Protokollin Shtesë të Marrëveshjes ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin Atlantik Verior dhe Shteteve të tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (Protokolli i Parisit), i datës 28 gusht 1952, Marrëveshjen ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin Atlantik Verior dhe Shteteve të tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (Protokolli Shtesë i PfP SOFA), i datës 19 qershor 1995 dhe duke përfshirë Protokollin tjetër shtesë të Marrëveshjes ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin Atlantik Verior dhe Shteteve të tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (Protokolli tjetër Shtesë i PfP SOFA), i datës 19 dhjetor 1997;

duke pasur parasysh konceptin e angazhimit të forcave të NATO-s dhe forcave të koalicionit nën komandën e NATO-s dhe kontrollit ose nëpërmjet territorit të Republikës së Kroacisë gjatë periudhave të paqes, krizës, emergjencës dhe konfliktit në mbështetje të aktiviteteve ushtarake të NATO-s;

duke pasur parasysh konceptin e stërvitjeve dhe operacioneve që parashikohen të ndodhin me



NATO-n, Partneritetin për Paqe (PfP) dhe forca të tjera të udhëhequra nga NATO-ja;

dhe duke marrë parasysh nevojat e Republikës së Kroacisë që më poshtë referohet “Shteti Pritës”, dhe nevojat e Komandës Aleate për Operacionet (ACO) dhe Komandës Aleate për Transformimin (ACT), më poshtë e referuar si Komanda Strategjike (SCs);

kanë rënë dakord si më poshtë:

SEKSIONI 1

1. PËRKUFIZIME

Për qëllimet e këtij Memorandumi Mirëkuptimi që më poshtë referohet si “MOU” dhe të dokumenteve të tij mbështetëse zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1.1 Forcat – Të gjithë komponentët e forcës së udhëhequr nga NATO dhe PfP ose shtete të tjera që marrin pjesë nën drejtimin e NATO-s, që përfshin të gjithë personelin, kafshët, materialet dhe rezervat, së bashku me çdo komponent tjetër civil të këtyre forcave, siç përkufizohen te NATO SOFA, Protokoll i Parisit. Termi përfshin gjithashtu të gjitha anijet, avionët, automjetet, magazinat, pajisjet, dhe municionin, si dhe burimet e lëvizjes në ajër, tokë dhe det, së bashku me shërbimet e tyre mbështetëse, duke përfshirë kontraktuesit që dislokojnë ose mbështesin forcën.

1.2 Aktivitetet Ushtarake të NATO-s – Veprimet ushtarake, duke përfshirë stërvitjen, eksperimentimin operacional dhe aktivitete të ngjashme ose kryerjen e misioneve ushtarake strategjike, taktike, të shërbimit, trajnuese ose administrative të kryera nga forcat; procesi i zhvillimit të luftimit, duke përfshirë sulmin, lëvizjen, furnizimin dhe manovrat që nevojiten për të arritur objektivat e çdo lufte ose fushate.

1.3 Komandant i NATO-s – Një komandant ushtarak në zinxhirin e komandës së NATO-s.

1.4 Organizatat e NATO-s – Komandat ose repartet e organizuara të forcave nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.5 Komanda Ushtarake Ndërkombëtare – Komanda Ushtarake Ndërkombëtare në strukturat e integruara të komandës së NATO-s ose që u është dhënë statusi nga NAC/DPC. Përfshin aktivitetet që mund të jenë detashmente të përkohshme ose njësi të Komandave.

1.6 Komanda Kombëtare – Komandat e

forcave kombëtare nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.7 Komanda Shumëkombëshe – Komanda me personel nga më shumë se një shtet që formohen me marrëveshjen e shteteve pjesëmarrëse dhe nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.8 Shtete Dërguese (SNs) – Ato shtete dhe Komanda Ushtarake Ndërkombëtare ose elementët e tyre që angazhohen në territorin e HN-së në mbështetje të operacioneve të NATO-s.

1.9 Shteti Pritës (HN) – Republika e Kroacisë.

1.10 Komanda ose Komandantët Strategjikë (SCs) – Komandanti Suprem i Aleatëve në Europë (SACEUR), komandanti i Shtabit Aleat për Operacionet (ACO) dhe Shtabit Suprem Aleat për Transformimin (SACT), Komandanti i Shtabit Aleat për Transformimin (ACT).

1.11 Mbështetja e Shtetit Pritës (HNS) – Asistenca civile dhe ushtarake që u jepet në kohë paqeje, emergjence, krize, konflikti nga një shtet pritës forcave dhe organizatave aleate që ndodhen, operojnë ose kalojnë tranzit përmes territorit, ujërave territoriale ose hapësirës ajrore të shtetit pritës.

1.12 Mbrojtja e Forcës (FP) – Të gjitha masat e marra dhe mjetet që përdoren për të minimizuar vulnerabilitetin e personelit, mjediseve, pajisjeve dhe operacioneve ndaj çdo rreziku në të gjitha situatat, për të ruajtur lirinë e veprimit dhe efektivitetin operacional të forcës.

1.13 Shpenzimet – Ato shpenzime që shoqërohen me ngritjen, mbështetjen dhe mbajtjen e komandave, forcave kombëtare, shumëkombëshe ose ndërkombëtare ose të formacioneve të NATO-s. Për qëllimet e këtij MOU-je dhe dokumenteve të saj mbështetëse:

a. Shpenzimet e Zakonshme të NATO-s – Ato shpenzime për të cilat bihet dakord paraprakisht të jenë përgjegjësi e përbashkët e Aleancës.

b. Shpenzime të Përbashkëta – Ato shpenzime për të cilat bihet dakord paraprakisht të jenë përgjegjësi e përbashkët e më shumë se një shteti. Masat e Shpenzimeve të Përbashkëta bazohen zakonisht në një formulë të detajuar në Marrëveshjen Teknike përkatëse dhe/ose Marrëveshjet e Përbashkëta të Zbatimit.

c. Shpenzime të Drejtpërdrejta Kombëtare – Ato shpenzime që konsiderohen të jenë përgjegjësi e një SP-je të vetëm.



1.14 Financim i Përbashkët i NATO-s – Fondet e dhëna nga shtetet e NATO-s dhe që ofrohen me miratimin nëpërmjet buxheteve të NATO-s për Shpenzimet e Zakonshme që shkaktohen gjatë zhvillimit të aktiviteteve ushtarake të NATO-s të përcaktuara në të.

1.15 Notë Pranimi (NOA) – Një dokument që tregon synimin e një SN-je për të marrë pjesë në masat për HNS-në sipas dispozitave të këtij MOU-je për një operacion të përcaktuar të drejtuar nga NATO.

1.16 Deklaratë Synimi (SOI) – Një dokument që tregon një synim të një SN-je për të marrë pjesë në masat për HNS-në sipas dispozitave të këtij MOU-je, por duke iu nënshtruar rezervave të caktuara specifike. HN-ja konfirmon nëse rezervat janë të pranueshme apo jo për dhënien e HSN-së.

1.17 Marrëveshje Teknike (TA) – Një marrëveshje pasuese dypalëshe për një operacion të caktuar të drejtuar nga NATO. Ajo detajon përgjegjësitë dhe procedurat për dhënien e HNS-së nga HN-ja ndaj Komandantit të NATO-së dhe SN(ve).

1.18 Marrëveshje e Përbashkët Zbatimi (JIA). Një marrëveshje pasuese dypalëshe që vendos angazhimin ndërmjet palëve nënshkruese në lidhje me dhënien dhe marrjen e HNS-së. Kjo përfshin informacionin e hollësishëm për mbështetjen e kërkuar dhe të ofruar, procedurat e specifikuara të vendit për zbatimin dhe rimbursimin ose kushtet e pagesës.

1.19 Komiteti Drejtues i Mbështetjes së Përbashkët të Shtetit Pritës (JHNSSC) – Një komitet i ngritur në mënyrë të posaçme dhe i bashkëkryesuar nga HN-ja dhe Komandanti i NATO-s. Komiteti, i përbërë nga përfaqësuesit e autorizuar nga të gjithë SN-të, HN-ja dhe Komandanti i NATO-s, takohen për të zhvilluar masat e nevojshme përforcuese në lidhje me HNS-në, si TA-në dhe JIA(të), sipas rastit.

1.20 Vendet Operacionale – Vendet që ndodhen në territorin e HN-së për qëllimin e mbështetjes operationale dhe/ose logjistike për forcën për operationet e drejtuara nga NATO. Këto vende janë detashmente të një Komande Strategjike nën komandën dhe kontrollin e Komandantit të NATO-s.

1.21 Të gjitha diferencat në lidhje me interpretimin e termave dhe përkufizimeve që nuk janë specifikuar në këtë MOU, zgjidhen me

bisedime, në pajtim me Fjalorin e Termave dhe Përkufizimeve të NATO-s (AAP-6).

SEKSIONI 2

2. QËLLIMI

2.1 Qëllimi i këtij MOU-je është krijimi i politikës dhe procedurave për përcaktimin e vendeve operationale dhe ofrimin e HNS-së të forcat e NATO-s ose të mbështetur nga HN-ja gjatë aktiviteteve ushtarake të NATO-s.

2.2 Ky MOU dhe dokumentet e tij pasuese synohet të shërbejnë si bazë për planifikimin nga autoriteti përkatës i HN-së dhe nga Komandantët e NATO-s duke parashikuar masat e HNS-së për një sërë aktiviteteve ushtarake të NATO-s. Këto misione përfshijnë ato për të cilat janë identifikuar forcat e angazhuara dhe ato për të cilat duhet të identifikohen forcat.

SEKSIONI 3

3. OBJEKTI DHE MASA TË PËRGJITHSHME

3.1 Dispozitat e NATO-s ose Pfp SOFA, Protokollit të Parisit dhe Protokollit tjetër Shtesë dhe çdo marrëveshjeje tjetër përkatëse që mund të jenë në fuqi ndërmjet Komandave Supreme dhe HN-së zbatohen për të gjitha aktivitetet ushtarake të NATO-s.

3.2 HN-ja njeh vendet operationale të ngritura sipas këtij MOU-je si detashmente të Komandës Supreme krijuese dhe aktivitetet e këtyre detashmenteve si sipërmarrje të Komandës Supreme. Vendet që duhet të vendosen, identifikohen në dokumente pasuese. Masat e komandës dhe kontrollit do të caktohen në planet përkatëse operationale ose planet e stërvitjes.

3.3 Ky MOU synon të jetë në pajtim me doktrinën dhe politikën e NATO-s dhe ofron një masë dhe strukturë ombrellë për HNS-në.

3.4 HN-ja do të japë mbështetje brenda kapacitetit të tij të plotë, duke iu nënshtruar disponibilitetit dhe brenda kufizimeve praktike të rrethanave që ekzistojnë për momentin, për forcat e dislokuara në aktivitetet ushtarake të NATO-s. Hollësitë e kësaj mbështetjeje do të trajtohen në dokumente shtesë.

3.5 Dispozitat e këtij MOU-je zbatohen në kohë paqeje, emergjence, krize dhe konflikti ose periudha të tensionit ndërkombëtar, siç mund të



përcaktohet reciprokisht nga HN-ja dhe Autoritetet e NATO-s.

3.6 Ndërsa SN-të dërguese inkurajohen të marrin pjesë në operacionet e NATO-s dhe të pranojnë dispozitat e këtij MOU-je, si një dokument ombrellë sipas të cilit HNS-ja jepet nga HN-ja, marrëveshjet e veçanta bilaterale me shtetet individuale mund të merren parasysh nga HN-ja rast pas rasti.

3.7 HN-ja dhe SC-të mund të caktojnë përfaqësues për të negociuar dokumentet që mbështesin dhe zhvillojnë më tej këtë MOU.

3.8 Aktivitetet ushtarake të drejtuara nga NATO të mbështetura nga ky MOU mund të kërkojnë operacione të mbështetjes shumëkombëshe me avionë dhe helikopterë, dhe në rastin e porteve, me anije mbështetëse ushtarake dhe mallrash. HN-ja pranon që lëvizja e këtyre avionëve, helikopterëve, anijeve dhe ekuipazhit të tyre në dhe përmes zonave territoriale të HN-së do të bëhet në bazë të një lejeje të përgjithshme për kohëzgjatjen e aktivitetit ushtarak të NATO-s. HN-ja administron/kontrollon të gjitha aspektet e një lejeje të tillë.

SEKSIONI 4

4. DOKUMENTET REFERUESE

Dokumentet referuese që mund të jenë të zbatueshme për këtë MOU ndodhen në aneksin A.

SEKSIONI 5

5. PËRGJEGJËSITË

Brenda kuadrit të dispozitave të këtij MOU-je

5.1 Shteti Pritës

a) Gjatë zhvillimit të dokumenteve mbështetëse dhe me ndodhjen e ndryshimeve dhe pas përfundimit të këtyre dokumenteve, HN-ja bën njoftim në kohën e duhur për Komandantin përkatës të NATO-s në lidhje me disponibilitetin ose ndonjë mangësi të aftësive të HNS-së. HN-ja merr parasysh që planifikuesit e NATO-s bazohen te dokumentet mbështetëse të përgatitura për këtë MOU dhe kërkojnë një njoftim në kohë për ndryshimet e planifikuara për strukturat dhe aftësitë kombëtare.

b) Me qëllim që të jepet mbështetje, HN-ja merr masat e nevojshme për burimet e mbështetjes për të përfshirë burimet civile dhe tregtare. Mbështetja e sigurtuar me prokurim sigurohet nëpërmjet një procesi ofertimi konkurrues në

pajtim me rregulloret e zbatueshme të NATO-s dhe rregullat dhe rregulloret mbi prokurimin publik në HN.

c) HN-ja mban regjistrat administrativë dhe financiarë të nevojshëm për të realizuar rimbursimin e HN-së për burimet e dhëna për forcat. Regjistrat që dokumentojnë transaksionet e financuara nga buxheti i NATO-s ofrohen për NATO-n, siç kërkohet nga qëllimet e auditimit.

d) Standardet e mallrave dhe shërbimeve të dhëna nga HN-ja do të jenë në pajtim me hollësitë e përcaktuara në dokumentet mbështetëse.

e) HN-ja do të ruajë kontrollin mbi burimet e veta të HNS-së, përveç kur kontrolli i këtyre burimeve është lënë i lirë.

f) HN-ja do të ofrojë, para çdo operacioni të NATO-s, një listë çmimesh për çdo mbështetje përkatëse ose të identifikuar të HN-së.

g) HN-ja do të ftojë SN-të të pranojnë dispozitat e këtij MOU-je nëpërmjet një note pranimi ose deklarimi synimi.

h) HN-ja (në bashkërendim me Komandantin e NATO-s) i jep forcës mbështetje mjekësore dhe dentare nga personeli/mjediset ushtarake të HN-së sipas të njëjta kushteve që u jep ushtarakëve të HN-së.

i) HN-ja parashikon procedurat për lidhjet mjekësore ndërmjet HN-së dhe SN-së, duke përfshirë POC-të mjekësore.

j) Gjatë përgatitjes së dokumenteve mbështetëse dhe pasuese, HN-ja do t'i japë Komandantit të NATO-s kopje në gjuhën angleze të çdo rregulloreje shëndetësore, sigurie, mjedisore, mbrojtjen e natyrës dhe bujqësore, që mund të zbatohet për Operacionin e NATO-s, si dhe çdo rregulloreje në lidhje me ruajtjen, zhvendosjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme brenda mjeteve dhe mundësive.

k) HN-ja pranon që kopjet e listës së mallrave të SN-së për pajisjet dhe furnizimet për përdorim ushtarak dhe personal në pajtim me NATO SOFA do të jenë dokumentacion i mjaftueshëm për qëllimet doganore.

5.2 Komandanti i NATO-s

a) Komandanti i NATO-s garanton, në masën maksimale të mundshme, që dokumentet mbështetëse të specifikojnë tipin, sasinë dhe cilësinë e mbështetjes së kërkuar. Vihet re që struktura e misionit dhe forcës që përcaktohet për një Plan Operacional (OPLAN), një Urdhër



Operacional (OPORD) ose një Urdhër Operacional Stërvitor (EXOPORD) nuk mund të specifikohet para kohe. Komandanti i NATO-s jep informacionin e nevojshëm shtesë për planifikimin e HN-së sa më shpejt të jetë e mundur.

b) Komandanti i NATO-s i dërgon HN-së njoftim në kohë në lidhje me çdo ndryshim të rrethanave dhe propozon ndryshimin e dokumenteve mbështetëse dhe pasuese, sipas rastit.

c) Komandanti i NATO-s përcakton nëse ofrohet financimi i zakonshëm dhe cilat kërkesa janë të përshtatshme për financim të zakonshëm.

d) Komandanti i NATO-s përcakton dhe vendos prioritetet e kërkuara të HNS-së dhe aprovon çmimet në lidhje me shpenzimet e zakonshme.

e) Komandanti i NATO-s garanton rimbursimin financiar për HN-në për HNS-të e rëna dakord, nëse paguhet nga financimi i zakonshëm. Në të gjitha rastet e tjera, Komandanti i NATO-s ndihmon në masën që është e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve financiare ndërmjet HN-së dhe SN-ve.

f) Nëse kërkesat e SN-ve janë në konflikt me prioritetet e Komandantit të NATO-s për shpërndarjen e burimeve, Komandanti përkatës i NATO-s e zgjidh konfliktin me SN-të e përfshira.

g) Komandanti i NATO-s identifikon personelin dhe kërkesat e tjera për Operacionin e vendeve që caktohen në HN.

h) Komandanti i NATO-s do të lehtësojë standardizimin e kërkesave dhe kostos së mbështetjes gjatë negociatave dhe/ose tek JHNSSC-ja.

5.3 Shtetet Dërguese

a) SN-të mund të zgjedhin të marrin pjesë në strukturën dhe procedurat për HNS-në duke pranuar dispozitat e këtij MOU-je nëpërmjet një NOA-je ose duke nxjerrë një SOI për një operacion të caktuar të NATO-s.

b) SN-të identifikojnë kërkesat e HNS-s ndaj HN-së dhe Komandantit përkatës të NATO-s.

c) Për kërkesat e Kostos së Drejtpërdrejtë Kombëtare, SN-ja normalisht merr pjesë në negociatat për HNS-të gjatë JHNSSC-së ose drejtpërdrejt me HN-në, nëse nuk krijohet një JHNSSC. SN-të ofrojnë pagesën e drejtpërdrejtë ose rimbursimin për HNS-të ndaj HN-së vetëm për shërbimet e dhëna nga burimet ushtarake, përveç kur përdoren, siç është rënë dakord,

procedura të tjera pagese. Sipas masave kontraktuale të marra nga HN-ja dhe SN-të, mbështetja e dhënë nga burimet tregtare ose civile do të paguhet drejtpërdrejt nga SN-të.

d) SN-të do të ofrojnë personel të autorizuar për të marrë pjesë në diskutimet e HNS-së gjatë JHNSSC-së, nëse krijohet.

e) SN-të do të raportojnë ndryshimet e kërkesave të HNS-së të HN-ja dhe Komandanti përkatës i NATO-s kur ato kryhen dhe paraqet kërkesat e rishikuara dhe/ose situacionet.

f) SN-të janë përgjegjëse për shpenzimet e çdo shërbimi mjekësor ose dentar të dhënë nga HN-ja.

g) SN-të duhet të respektojnë rregulloret dhe procedurat e HN-së për shëndetin, sigurinë, mjedisin dhe bujqësinë që janë identifikuar për vendet operacionale, si dhe çdo rregullore të HN-së për ruajtjen, zhvendosjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme.

SEKSIONI 6

6. MASA FINANCIARE

6.1 Me marrëveshje të ndërsjellë dhe/ose konventa ndërkombëtare, aktivitetet e Komandave Ushtarake Ndërkombëtare, vendet operacionale, anijet, avionët ose automjetet në pronësi dhe/ose të kontraktuara nga NATO, dhe karburanti, vajrat dhe lubrifikantët (POL) dhënë forcave të NATO-s janë të përjashtuara nga tatimet, detyrimet, pagesat shtetërore, tarifat dhe të gjitha pagesat e ngjashme.

6.2 Protokollin e Parisit, Protokollin tjetër Shtesë dhe e drejta zakonore ndërkombëtare që zbaton imunitetet dhe privilegjet e një Komande Ushtarake Ndërkombëtare do të zbatohet për çdo element ose detashment të komandës që mund të vendosen në HN-në pas zbatimit të një operacioni të drejtuar nga NATO.

6.3 Pajisjet, furnizimet, produktet, materialet dhe shërbimet e importuara përkohësisht dhe eksportuara nga territori i HN-së ose të eksportuara nga territori i HN-së në lidhje me një aktivitet ushtarak të NATO-s janë të përjashtuara nga të gjitha doganat, tatimet dhe tarifat. Procedurat e tjera doganore do të përcaktohen në pajtim me NATO-n ose Pfp SOFA, Protokollin e Parisit dhe Protokollin tjetër Shtesë, sipas rastit.

6.4 Nëse përjashtimi i plotë nga tatimet, detyrimet, tarifat ose pagesat e ngjashme nuk është e mundur, për blerjet që kryhen në ekonominë e brendshme të HN-së, detyrimet nuk vendosen në



një më të lartë se ai që zbatohet për Forcat e Armatosura të HN-së. Të gjitha shpenzimet duhet të përpunohen me shumën më të vogël që shoqëron kërkesat administrative.

6.5 Transaksionet financiare që përfshijnë transferimin e fondeve dhe krijimin e llogarive në çdo institucion bankar privat ose qeveritar duhet të kryhen pa marrë asnjë pagesë apo tarifë të asnjë lloji.

6.6 Masat përfundimtare financiare, veçanërisht ato në lidhje me financimin e zakonshëm të NATO-s, do të vendosen vetëm para zbatimit të Operacionit të NATO-s. Të gjitha masat financiare që negociohen paraprakisht duhet të jenë specifike në lidhje me detyrimet financiare maksimale të NATO-s. Shpenzimet për të cilat nuk bihet specifikisht dakord që të jenë shpenzime të financuara nga NATO, para se të realizohen shpenzimet, nuk marrin financim të zakonshëm nga NATO.

6.7 Dokumentet pasuese ofrojnë bazën fillestare për vlerësimet e shpenzimeve dhe shërbejnë si bazë për kategorizimin e shpenzimeve si Shpenzime të Zakonshme të NATO-s (sipas rastit), Shpenzime të Përbashkëta ose Shpenzime të Drejtpërdrejta Kombëtare.

6.8 Nëse Komandanti i NATO-s përcakton që disa shpenzime janë të përshtatshme dhe të përballueshme nga financimi i zakonshëm i NATO-s (nga alokimet e aprovuara të buxhetit), SC-ja përkatëse autorizon financimin e zakonshëm për ato shpenzime dhe i paguan drejtpërdrejt ose rimbursos HN-në.

6.9 Nëse shpenzime të caktuara përcaktohen t'i takojnë më shumë se një shteti, këto shpenzime mund të identifikohen si shpenzime të përbashkëta dhe, nëpërmjet marrëveshjes së përbashkët të shteteve të përfshirë, mund të ndahen në pajtim me formulën e ndarjes së shpenzimeve të aprovuara në TA ose dokumente të tjera mbështetëse.

6.10 Detyrimet për materialet dhe shërbimet civile dhe ushtarake të dhëna nga HN-ja nuk vendosen me një normë më të lartë se ato që u ngarkohen Forcave të Armatosura të HN-së dhe nuk përfshijnë shpenzime të tepërta administrative ose të tjera, por mund të reflektojnë përshtatje për shkak të grafikëve të dorëzimit, pikave të dorëzimit ose faktorëve të ngjashëm. Rimbursimi nuk paguhet për mbështetjen e dhënë nga personeli ushtarak.

6.11 Komandanti i NATO-s dhe SN-të mund të kontraktojnë drejtpërdrejt me furnizuesit tregtarë për furnizime marrjen me qira të automjeteve, shërbime ose mbështetje tjetër.

6.12 Automjetet në pronësi të NATO-s dhe automjetet ushtarake të SN-së janë të vetësiguruara dhe si të tilla mund të operojnë pa siguracion tregtar.

6.13 HN-ja nuk shkakton asnjë detyrim financiar në emër të Komandantit të NATO-s ose SN-së, përveç kur i kërkohet specifikisht ta bëjë këtë paraprakisht nga një përfaqësues i autorizuar dhe përveç kur është rënë dakord për përgjegjësinë për pagesën e shpenzimeve. Për më tepër, asnjë fond nuk jepet para se SC(të) ose SN(të), sipas rastit, të kenë aprovuar dokumentet përkatëse mbështetëse dhe të kenë udhëzuar zbatimin e tyre.

6.14 Nuk është dhënë financim në lidhje me këtë MOU dhe ky dokument nuk përfaqëson ndonjë detyrim specifik financimi nga ana e Komandantit të NATO-s ose SN-ve. Masat e hollësishme financiare dhe procedurat e rimbursimit do të specifikohen në dokumentet mbështetëse.

6.15 Caktimi i vendeve operationale në mbështetje të një operacioni të NATO-s nuk parashikon ndërtim ose rehabilitim infrastrukture.

SEKSIONI 7

7. KONSIDERATA JURIDIKE

7.1 Komandat Supreme do të kryejnë ose mund të delegojnë veprimet juridike që janë thelbësore për përmbushjen e misioneve, duke përfshirë, por pa u kufizuar në ushtrimin e kapacitetit për të lidhur kontrata, angazhuar në procedura ligjore ose administrative, dhe të përftojnë dhe disponojnë mbi pronën.

7.2 Statusi i forcave të angazhuara në territorin e HN-së do të përcaktohet në pajtim me NATO-n ose PfP SOFA, Protokollin e Parisit dhe/ose Protokollin tjetër Shtesë.

7.3 Pretendimet jokontraktuale që rrjedhin ose janë në lidhje me ekzekutimin e këtij MOU-je trajtohen në pajtim me dispozitat e NATO-s ose PfP SOFA.

7.4 Pretendimet kontraktuale trajtohen dhe gjykohen nga HN-ja, nëpërmjet procesit që rregullon kontratat civile dhe në pajtim me të drejtën e HN-së, me rimbursim nga Komandanti i NATO-s ose SN-ja, sipas rastit.



SEKSIONI 8

8. MBROJTJA E FORCËS

8.1 FP-ja e plotë dhe efektive e Forcës (FP) planifikohet për Komandën statike të NATO-s dhe të gjitha aktivitetet e ngjashme ushtarake dhe detajohet në OPLANS, EXPI ose Masat Pasuese, sipas rastit. FP-ja zbatohet në pajtim me politikën dhe procedurat e NATO-s dhe në një mënyrë që është në pajtim me NATO/PfP SOFA. FP-ja nuk kërkohet në asnjë rrethanë të jetë në kundërshtim me NATO PfP SOFA ose ligjet e HN-së.

8.2 Sipas rastit, HN-ja do të informojë SN-në dhe Komandantin e NATO-s për masat dhe kufizimet e propozuara për FP-në.

8.3 Sipas rastit, çdo SN është përgjegjës për identifikimin dhe parashikimin e kërkesave dhe kufizimeve të FP-së të HN-ja dhe Komandanti i NATO-s.

8.4 Përveç këtyre përgjegjësive të FP-së të detajuara në politikën dhe procedurat e NATO-s për FP-në, Komandanti i NATO-s është përgjegjës për bashkërendimin e të gjithë elementëve të kërkuar dhe të paraqitur për HN dhe SN FP-në, sipas rastit, për mbrojtjen e forcave.

SEKSIONI 9

9. SIGURIA DHE DEKLARIMI I INFORMACIONIT

9.1 Ndërmjet Shteteve Aleate informacioni i klasifikuar i ruajtur, trajtuar, gjeneruar, transmetuar ose shkëmbyer si rezultat i ekzekutimit të këtij MOU-je trajtohet në pajtim me C-M (2002) 49, “Siguria brenda Organizatës së Traktatit Atlantik Verior”, të datës 17 qershor 2002, në botimin e autorizuar përkatës, duke përfshirë të gjitha shtojcat dhe ndryshimet në të dhe në marrëveshjet dhe masat ekzistuese për sigurinë.

9.2 Informacioni i dhënë nga një pjesëmarrës ose SN një tjetri në mirëbesim dhe çdo informacion i tillë i nxjerrë nga një pjesëmarrës ose SN, i cili kërkon konfidencialitet, ruan klasifikimin e tij origjinal ose i caktohet një klasifikimi që garanton një shkallë të mbrojtjes ndaj deklarimit, të barabartë me atë që kërkohet nga pjesëmarrësi ose SN-ja.

9.3 Çdo pjesëmarrës dhe SN ndërmerr të gjitha hapat e ligjshëm të mundshëm për moszbulimin e të gjithë informacionit të shkëmbyer në mirëbesim, përveç kur pjesëmarrësit ose SN-të bien dakord për këtë deklaram.

9.4 Për të ndihmuar në dhënien e mbrojtjes së dëshiruar, çdo pjesëmarrës ose SN e shënon këtë informacion të dhënë tjetrit në mirëbesim me një legjendë që tregon origjinën, klasifikimin e sigurisë dhe kushtet e tij të deklarimit, që informacioni lidhet me një operacion të NATO-s dhe që është dhënë në mirëbesim.

9.5 Vizitat nga personeli do të rregullohen në pajtim me procedurat e specifikuar në C-M(2002)49, i ndryshuar.

9.6 I gjithë informacioni i klasifikuar që i nënshtrohet dispozitave të këtij seksioni do të vazhdojë të mbrohet në rastin e tërheqjes së një pjesëmarrësi ose pas prishjes së këtij MOU-je.

SEKSIONI 10

10. HYRJA NË FUQI, KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI

10.1 Ky MOU zbatohet provizorisht nga data e nënshkrimit të fundit dhe hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas datës në të cilën Qeveria e Republikës së Kroacisë ka njoftuar palët e tjera për përfundimin e procedurës së brendshme ligjore të nevojshme për këtë qëllim.

10.2 Ky MOU mbetet në fuqi përveç kur prishet nga një palë, duke bërë një njoftim gjashtëmuajor paraprak drejtuar palëve të tjera.

10.3 Të gjitha dispozitat e seksioneve 6, 7 dhe 9 mbeten në fuqi në rastin e tërheqjes së një pjesëmarrësi ose të përfundimit të këtij MOU-je deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve. SN-të përmbushin të gjitha detyrimet në rastin e prishjes apo tërheqjes nga ky MOU.

SEKSIONI 11

11. NDRYSHIMI DHE INTERPRETIMI

11.1 Ky MOU mund të ndryshohet ose modifikohet me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të të gjithë pjesëmarrësve.

11.2 Të gjitha konfliktet në interpretimin dhe zbatimin e këtij MOU-je zgjidhen me konsultime ndërmjet palëve në nivelin më të ulët të mundshëm dhe nuk i referohen asnjë gjykatë kombëtare ose ndërkombëtare apo pale të tretë për zgjidhje.

11.3 Ky MOU është nënshkruar në tri kopje, secila në gjuhën kroate dhe angleze, ku të dyja tekstet janë njëloj autentike. Çdo mospërputhje në interpretimin e këtij MOU-je zgjidhet sipas versionit në anglisht nëpërmjet konsultimeve ndërmjet palëve në nivelin më të ulët të mundshëm.



Sa më sipër përfaqëson marrëveshjet e arritura ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleate për Transformimin, si dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Europë, për çështjet e përmendura në të.

NËNSHKRUAR:

Për Qeverinë e Republikës së Kroacisë (Nënshkrimi)

NIKOLA BRZICA, M. Sc.
Ndihmësministër i Mbrojtjes
Datë 8.4.2016
Zagreb, Republika e Kroacisë

Për Komandën Supreme të Fuqive Aleate në Europë dhe Shtabin e Komandës Supreme Aleate për Transformimin:

(Nënshkrimi)
Werner Freers
Gjeneral, Ushtria DEU
Shef Shtabi
Datë 24.5.2016
Mons, Mbretëria e Belgjikës

NATO E PAKLASIFIKUAR

ANEKSI A DOKUMENTET REFERUESE

- a) Traktati Atlantik i Veriut, i datës 4 prill 1949.
- b) Marrëveshje ndërmjet Palëve të Traktatit Atlantik të Veriut në lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (NATO SOFA), e datës 19 qershor 1951.
- c) Protokoll i mbi Statusin e Komandave Ushtarake Ndërkombëtare të krijuara në pajtim me Traktatin Atlantik të Veriut (Protokoll i Parisit), i datës 28 gusht 1952.
- d) Marrëveshje ndërmjet Shteteve Palë të Traktatit Atlantik të Veriut dhe Shteteve të tjera që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin Forcave të tyre (PfP SOFA), e datës 19 qershor 1995.
- e) Protokoll Shtesë për Marrëveshjen ndërmjet Shteteve Palë të Traktatit Atlantik të Veriut dhe Shteteve të tjera që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin Forcave të tyre (Protokoll Shtesë i PfP SOFA), e datës 19 qershor 1995.

f) Protokoll i tjetër Shtesë i Marrëveshjes ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin e Atlantikut Verior dhe Shteteve të tjera që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (Protokoll i tjetër Shtesë), datë 19 dhjetor 1997.

g) MC 319/2 – Parimet dhe Politikat e NATO-s për Logjistikën.

h) MC 334/2 – Parimet dhe Politikat e NATO-s për Mbështetjen e Shtetit Pritës (HNS).

i) NATO STANAG-e të zbatueshme dhe Direktivat Politike për Mbështetjen Logjistike, Mbrojtjen e Forcës dhe Rimbursimin Financiar.

j) C-M(2002)49 – Siguria brenda NATO-s, i datës 17 qershor 2002.

k) Direktiva BI-SC 15-3 – Përgatitja e Marrëveshjeve Ndërkombëtare.

l) AJP-4.5(B) – Doktrina e Përbashkët Aleate për Mbështetjen e Shtetit Pritës dhe Procedurat.

m) C-M (2002) 50 – Masat Mbrojtëse për Organet Civile dhe Ushtarake të NATO-s, Forcat dhe Njësitë (Asetet) e Angazhuara të NATO-s kundër Kërcënimeve Terroriste.

n) BI-SC Direktiva e Mbrojtjes së Forcës 80-25, 1 janar 2003.

o) Bi-SC Udhëzim Planifikimi Funksional për Mbrojtjen e Forcës.

p) AAP-6-Fjalori i NATO-s për Termat dhe Përkufizimet.

NOTË PRANIMI

PËR PJESËMARRJE NË MBËSHTETJEN E SHTETIT PRITËS DHE PËRGJEGJËSITË FINANCIARE DHE TË TJERA TË KAKTUARA BRENDË REPUBLIKËS SË KROACISË (HOST NATION) PËR OPERACIONET/STËRVITJET

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (SN), i përfaqësuar nga ALB NMR në SHAPE, Kapiten (N) Adnand Agastra,

pasi ka vendosur që Forcat e tij të Armatosura do të marrin pjesë në stërvitjet dhe/ose operacionet në lidhje me aktivitet në kontekstin e planit të veprimit të gatishmërisë së aprovuar nga Këshilli Atlantik Verior;

duke marrë parasysh konceptin e përgjithshëm të Operacionit/Stërvitjes së NATO-s brenda doktrinës së NATO-s, dhe



me dëshirën për të marrë pjesë në masat në lidhje me mbështetjen e shtetit pritës dhe përgjegjësitë financiare dhe të tjera të Republikës së Kroacisë, Komanda Supreme e Fuqive Aleate në Europë (SHAPE) dhe Shtabi i Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) dhe Shtetet e tjera dërguese në lidhje me mbështetjen e këtyre forcave të armatosura gjatë stërvitjeve dhe operacioneve në lidhje me aktivitetet në kontekstin e Planit të Veprimit të Gatishmërisë;

zgjedh të marrë pjesë dhe të respektojë dispozitat e përfshira në:

“Memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin dhe Komandës Supreme e Fuqive Aleate në Europë, në lidhje me dhënien e mbështetjes së shtetit pritës gjatë ekzekutimit të aktiviteteve ushtarake të NATO-s, që ka hyrë në fuqi në 1 shkurt 2017:

Si Shtet Dërgues për aktivitetet ushtarake në lidhje me ndërmarrjet në kontekstin e Planit të Veprimit të Gatishmërisë nëpërmjet MOU-së së përmendur më sipër.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës
së Shqipërisë
ALB NMR në SHAPE, Kapiten (N) Adnand
Agastra

Datë 13.10.2017

VENDIM

Nr. 725, datë 8.12.2017

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 728, DATË 20.10.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN E NATO-S “AEGEAN SEA””, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, e 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për Faqe | 11890

pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 728, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 2, pas fjalëve “... në detin Egje ...” shtohen “... dhe për personelin në anijen flamurtare, në bazë të kërkesave operacionale të saj, edhe në detin Mesdhe dhe Detin e Zi ...”.

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Kohëzgjatja e pjesëmarrjes në këtë operacion e anijes së klasit “Iliria” dhe personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është, si më poshtë vijon:

a) Për anijen e klasit “Iliria”, deri më 30 nëntor 2018, me sistem rotacioni. Periudha e rotacionit të anijes është çdo 6 (gjashtë) muaj;

b) Për 21 (njëzet e një) ushtarakë, deri më 30 nëntor 2018, me sistem rotacioni. Periudha e rotacionit është çdo 3 (tre) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës;

c) Për ushtarakun, oficer shtabi, në Grupin Detar të Përhershëm të NATO-s, në anijen flamurtare, deri më 31 dhjetor 2018, me sistem rotacioni. Periudha e rotacionit është çdo 3 (tre) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me përfaqësuesin e radhës.”.

c) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Rajoni i venddislokimit të anijes së klasit “Iliria” dhe i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të jetë, si më poshtë vijon:

a) Për anijen e klasit “Iliria” dhe 21 (njëzet e një) ushtarakë, në detin Egje;

b) Për ushtarakun, oficer shtabi, në Grupin Detar të Përhershëm të NATO-s, në anijen flamurtare, në detin Egje dhe në bazë të kërkesave operacionale të anijes flamurtare, në detin Mesdhe dhe Detin e Zi.”.

ç) Në shkronjën “e”, të pikës 5, pas fjalës “... telefon ...” shtohen “... instalim të radiove të komunikimit ...”.



2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 726, datë 8.12.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 910, DATË 22.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK NDËRKOMBËTAR “KFOR”, KOSOVË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 910, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, numri “9 (nëntë)” ndryshohet dhe bëhet “10 (dhjetë)”.

2. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 727, datë 8.12.2017

PËR TRANSFERIMIN E PRONËS SHTETËRORE SIPAS HARTËS TREGUESE, ME NOMENKLATURË k-34-112-127-D, ME NUMËR PASURIE 402, 403, 404, 405, 406, 410 (NUMËR 19 SIPAS HARTËS SË KADASTRËS DAMT), 411 (NUMËR 20 SIPAS HARTËS SË KADASTRËS DAMT), 412, 413 e 414, ZONA KADASTRALE NR. 2443, BASHKIA FIER, NJËSIA ADMINISTRATIVE LIBOFSHË, DHE TË PRONËS SHTETËRORE SIPAS HARTËS TREGUESE, ME NOMENKLATURË k-34-111-(111-D), ME NUMËR PASURIE 220/1, 220/3, 221/1, 221/3, 224/1, 225/1, 226/1, 227/1, 227/3, 228/1, 228/3, 229/1, 229/3, 230/1, 231/1 e 232/1, ZONA KADASTRALE NR. 2085, KARAVASTA E RE, NJËSIA ADMINISTRATIVE REMAS, BASHKIA DIVJAKË, NË FONDIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME PËR MBËSHTETJEN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE DHE VËNIEN NË DISPOZICION TË PASURISË SË PALUAJTSHME SHTETËRORE PËR ZHVILLIMIN DHE REALIZIMIN E PROJEKTIT INVESTUES STRATEGJIK “ALBPANEL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin dhe përfshirjen e pronës së paluajtshme shtetërore, të kategorisë së resursit “arë”, me vendndodhje dhe sipërfaqe sipas aneksit I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe bazuar në hartën treguese, me nomenklaturë k-34-112-127-D e me regjistrim kadastral: zona kadastrale nr. 2443, Bashkia Fier, njësia administrative Libofshë, me numër pasurie: 402, 403, 404, 405, 406, 410 (numër 19 sipas hartës së kadastrës DAMT), 411 (numër 20 sipas hartës së kadastrës DAMT), 412, 413 dhe 414, me institucion administrues Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në Fondin e Pasurive të



Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS).

2. Për pasuritë me numër parcelash 410 (numër 19 sipas hartës së kadastrës DAMI) dhe 411 (numër 20 sipas hartës së kadastrës DAMI) në zonën kadastrale nr. 2443, Bashkia Fier, njësia administrative Libofshë, të ndërmerren nga Bashkia Fier dhe ZVRPP-ja Fier procedurat për realizimin e regjistrimit të tyre fillestar, pasi këto parcela figurojnë të dubluara në hartën treguese të regjistrimit, por nuk figurojnë në kartelat e pasurive.

3. Transferimin dhe përfshirjen e pronës së paluajtshme shtetërore, të kategorisë së resursit “arë”, me vendndodhje dhe sipërfaqe sipas aneksit II, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe bazuar në hartën treguese, me nomenklaturë k-34-111-(111-D) dhe me regjistrim kadastral: zona kadastrale nr. 2085, Karavasta e Re, njësia administrative Remas, Bashkia Divjakë, me numër pasurie 220/1, 220/3, 221/1, 221/3, 224/1, 225/1, 226/1, 227/1, 227/3, 228/1, 228/3, 229/1, 229/3, 230/1, 231/1 e 232/1, me institucion administrues Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS).

4. Vënien në dispozicion të pasurisë së paluajtshme shtetërore, sipas përcaktimit të pikave 1, 2 dhe 3, të këtij vendimi, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik “Albpanel”, me subjekt investues “Albpanel NGR, NUIS/NIPT: L61605017K”, për 35 (tridhjetë e pesë) vite, me tarifën 1 euro. Afati i përdorimit fillon nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. E drejta e përdorimit të tokës shtetërore të kategorisë së resursit “arë” nga investitori strategjik “Albpanel NGR, NUIS/NIPT: L61605017K”, detyrimet dhe kushtet e përdorimit bazohen në vendimin nr. 7/1, datë 5.12.2016, të Komitetit të Investimeve Strategjike dhe marrëveshjen e garancive financiare që do të nënshkruhet, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe subjektit investues “Albpanel NGR, NUIS/NIPT: L61605017K”.

6. Bashkia Fier dhe Bashkia Divjakë të ndërmarrin nisjen e procedurave për vënien, brenda 3 (tre) muajve, në dispozicion të projektit të investimit “Albpanel” të sipërfaqes së nevojshme e të përshtatshme për projektin për ndërtimin e fabrikës e të ambienteve ndihmëse, bazuar në vendimin nr. 7/1, datë 5.12.2016, të Komitetit të Investimeve Strategjike.

7. Aplikimi për leje/licenca/autorizime për realizimin e investimit strategjik “Albpanel” realizohet sipas legjislacionit në fuqi për investimet strategjike.

8. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Bashkia Fier, Bashkia Divjakë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI I

ZONA KADASTRALE NR. 2443, BASHKIA FIER, NJËSIA ADMINISTRATIVE LIBOFSHË

Nr. rendor	Njësia administrative	Zona kadastrale	Numri i parcelës	Sipërfaqe në m ²
1.	Libofshë	2443	402	96400
2.			403	98200
3.			404	92200
4.			405	96900
5.			406	97700
6.			410 (nr. 19 sipas hartës së kadastrës DAMI)	Nevojitet regjistrim fillestar
7.			411 (nr. 20 sipas hartës së kadastrës)	Nevojitet regjistrim fillestar



			DAMT)	
8.			412	90800
9.			413	98300
10.			414	98300

ANEKSI II

ZONA KADASTRALE NR. 2085, KARAVASTA E RE, NJËSIA ADMINISTRATIVE REMAS

Nr. rendor	Njësia administrative	Zona kadastrale	Numri i parcelës	Sipërfaqe në m ²
1.	Remas	2085	220/1	33774
2.			220/3	64593
3.			221/1	18548
4.			221/3	148757
5.			224/1	166155
6.			225/1	149506
7.			226/1	144257
8.			227/1	14668
9.			227/3	64766
10.			228/1	16256
11.			228/3	90262
12.			229/1	11132
13.			229/3	98642
14.			230/1	81900
15.			231/1	72360
16.			232/1	34410

VENDIM

Nr. 729, datë 8.12.2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 244, DATË 30.3.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE PËR VENDOSJEN E DETYRIMIT TË SHËRBIMIT PUBLIK, QË DO TË ZBATOHEN NDAJ TË LICENCUARVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, TË CILËT USHTROJNË AKTIVITETIN E PRODHIMIT, TRANSMETIMIT, SHPËRNDARJES DHE FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin që i bashkëlidhet vendimit nr. 244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “c”, e pikës 1, të nenit 2, ndryshohet si më poshtë vijon:

“c) tarifat dhe çmimet për klientët që përfitojnë nga detyrimi i shërbimit publik;”.

2. Pas pikës 5, të nenit 4, shtohet pika 5/1, si më poshtë vijon:

“5/1. Në çdo rast të vendosjes së detyrimit publik ndaj shoqërisë së prodhimit, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, Asambleja e Përgjithshme e kësaj shoqërie, pasi merr mendimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, vlerëson rast pas rasti mbi mënyrën e përdorimit të të ardhurave shtesë mbi ato të parashikuara në programin ekonomik, nëse do të shërbejnë si fond rezervë për balancimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqërisë së prodhimit për periudhat e



ardhshme, me qëllimin e minimizimit të riskut hidrologjik.”.

3. Në nenin 5 bëhen këto ndryshime e shtesa:

a) Pikat 2 dhe 3 ndryshohen me këtë përmbajtje:

“2. Furnizuesit të Shërbimit Universal, për të përmbushur kërkesat e klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe vendimit nr. 449, datë 15.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve dhe procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”, i vendoset detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen nga shteti.

Sasia e energjisë elektrike, për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, duke u bazuar në nivelin historik mesatar vjetor të dhjetë viteve të fundit, sipas informacionit të dhënë nga ERE dhe regjimit racional të shfrytëzimit të kapaciteteve gjeneruese.

Për qëllime të përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, Asambleja e Përgjithshme e kësaj shoqërie do të marrë në konsideratë kostot e arsyeshme të parashikuara në programin ekonomik të miratuar për shoqërinë e prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, si dhe impaktin në tarifën e klientëve që përfitojnë nga Furnizuesi Universal.

Sasia e energjisë elektrike dhe çmimi i miratuar pasqyrohen nga palët në kontratën “tip” të miratuar nga ERE, sipas përcaktimeve të shkronjës “h”, të nenit 20, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

“3. Në rastet kur Furnizuesi i Shërbimit Universal nuk mund të sigurojë sasinë e nevojshme nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, sipas përcaktimeve të vendosura në pikën 2 të këtij neni, Furnizuesi i Shërbimit Universal ka detyrimin që të sigurojë sasinë e nevojshme të energjisë në tregun e parregulluar.

Furnizuesi i Shërbimit Universal kompensohet nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, për sasinë e pasiguruar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike sipas vlerës së përcaktuar në kontratë.”.

b) Pas pikës 4, të nenit 5, shtohen pikat 4/1 dhe 4/2 me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

“4/1. Shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, sasinë e mbetur të energjisë elektrike pas plotësimit të nevojave në përputhje me pikat 2, 3 dhe 4 të këtij neni, e tregton sipas parimeve të një tregu të lirë dhe konkurrues, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara, bazuar në rregulloren për tregtimin e energjisë elektrike, që miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

4/2. Bazuar në shkronjën “ë”, të pikës 1, të nenit 47, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe vendimit nr. 449, datë 15.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve dhe procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”, për qëllime të interesit publik, Furnizuesi i Shërbimit Universal, në kuadër të shërbimit publik, siguron pa ndërprerje furnizimin e klientëve, si më poshtë:

- Subjektet shtetërore që sigurojnë shërbimin e shëndetit publik (spitalet dhe qendrat e urgjencës);
- Shoqëri që sigurojnë furnizimin me ujë të pijshëm të konsumatorëve;
- Institucione shtetërore të ekzekutimit të vendimeve penale dhe institucione shtetërore, të cilat mbulojnë sigurinë kombëtare dhe rendin publik.”.

c) Pika 5, e nenit 5, riformulohet si më poshtë vijon:

“5. Me bërjen funksionale të Bursës Shqiptare të Energjisë, Këshilli i Ministrave përcakton kushtet e reja për furnizimin e klientëve të energjisë elektrike, të cilët përfitojnë nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, në kuadër të detyrimit të shërbimit publik.”.

Pika 3, e nenit 6, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Pasqyrimi i kostos bëhet duke përfshirë koston e blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria shtetërore e prodhimit, që përmban edhe kostot financiare të TEC Vlora sh.a., koston përkatëse për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga burime të rinovueshme, sipas parashikimeve të



legjislacionit në fuqi për burimet e rinovueshme dhe të blerjes së energjisë në tregun e parregulluar, koston për tarifat e transmetimit, shpërndarjes dhe të furnizimit të energjisë elektrike.”.

5. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 730, datë 8.12.2017

PËR DHËNIEN E BURSIVE
PËR NXËNËSIT E SHKOLLËS
SË MESME PROFESIONALE “PETER
MAHRINGER”, SHKODËR,
PËR VITIN SHKOLLOR 2017 - 2018

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 6 dhe 39 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9522, datë 25.4.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Austrisë për bashkëpunimin në fushat e kulturës, të arsimit dhe shkencës”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të 84 (tetëdhjetë e katër) bursave të studimit për nxënës të shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, nga të cilat 24 (njëzet e katër) bursa studimi për nxënës të viteve përgatitore dhe 60 (gjashtëdhjetë) bursa studimi për nxënës të viteve të para, deri në vitin e katërt të shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, për vitin shkollor 2017-2018.

2. Vlera e bursës do të jetë 99 360 (nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë për nxënësin në vit, me qëllim shlyerjen e tarifës mujore të shkollimit dhe për mbulimin e koston të teksteve mësimore. Vlera e masës së bursës do të paguhet

pranë bankave të nivelit të dytë për çdo nxënësin ose prind të nxënësit përfitues.

3. Fondi për mbulimin e këtyre bursave kalon nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Drejtorinë Arsimore Rajonale Shkodër.

4. Miratimi i këtyre bursave bëhet nga bordi i Fondacionit Shkollor Austriak, në mbështetje të kriterëve ekonomikë, si dhe rezultateve të arritura nga secili nxënësi/aplikant.

5. Bordi i Fondacionit Shkollor Austriak, pas miratimit të bursave, dërgon dokumentacionin përkatës në Drejtorinë Arsimore Rajonale Shkodër, e cila, pas konfirmimit të nxënësit që përfiton bursë, kalon masën e bursës në llogarinë personale të secilit nxënësin.

6. Efektet financiare të mbulohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 731, datë 8.12.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 36, DATË 16.1.2013, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR CAKTIMIN E
ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES TË
ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 33, datë 21.3.2013, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, dhe të pikës 5, të kreut II, të vendimit nr. 752, datë 2.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës dhe të kriterëve për caktimin e anëtarëve të bordit drejtues të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe të masës së shpërblimit të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit nr. 36, datë 16.1.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:



“1. Bordi drejtues i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të kryesohet nga z. Artan Lame, përfaqësues i Kryeministrit, dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:

a) Znj. Majlinda Dhuka, përfaqësues i Kryeministrit;

b) Znj. Jonida Gaba, përfaqësues i ministrit të Drejtësisë;

c) Z. Artur Metani, përfaqësues i ministrit të Drejtësisë;

ç) Znj. Gelardina Prodani, përfaqësues i ministrit të Financave dhe Ekonomisë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe bordi drejtues i saj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 732, datë 8.12.2017

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 744, DATË 5.11.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KALIMIN, NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, TË OBJEKTIT
“FAKULTETI I GJEOLGJISË DHE
MINIERAVE”, TIRANË, NGA MINISTRIA
E ARSIMIT DHE SPORTIT/
UNIVERSITETI POLITEKNIK I
TIRANËS, TE MINISTRIA E
DREJTËSISË, PËR GJYKATËN E LARTË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 744, datë 5.11.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në titull dhe kudo në përmbajtjen e vendimit, pas emërimit “Gjykatën e Lartë” shtohen fjalët “... dhe Shkollën e Magjistraturës ...”.

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:


“1/1. Nga sipërfaqja e truallit 12 478 (dymbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë) m², e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, sipërfaqja prej 3 205 (tre mijë e dyqind e pesë) m² i kalon Shkollës së Magjistraturës për ndërtimin e godinës, sipas projektidesë bashkëlidhur këtij vendimi.”.


c) Në pikën 3, fjalët “... pikën 1 ...” zëvendësohen me “... pikat 1 dhe 1/1 ...”.


2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama







**VENDIM**

Nr. 733, datë 8.12.2017

**PËR SHPALLJEN E QENDRËS
HISTORIKE TË FSHATIT THETH,
SHKODËR E TË ZONËS SË MBROJTUR
PËRRETH SAJ DHE MIRATIMIN
E RREGULLORES PËR ADMINISTRIMIN
E SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4, të nenit 29, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e Qendrës Historike të fshatit Theth, Shkodër e të Zonës së Mbrojtur përreth saj, sipas hartës dhe koordinatave gjeografike, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e rregullore “Për administrimin e Qendrës Historike të fshatit Theth, Shkodër e të Zonës së Mbrojtur përreth saj”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**






Tabela 1
KOORDINATAT GJEOGRAFIKE TË QENDRËS HISTORIKE TË FSHATIT THETH

Qendra Historike		
UTM Z 34N		
Emërtimi	Long.	Lat.
T1	E19° 46' 27.743"	N42° 23' 47.776"
T2	E19° 46' 29.313"	N42° 23' 47.999"
T3	E19° 46' 31.860"	N42° 23' 47.927"
T4	E19° 46' 32.425"	N42° 23' 48.001"
T5	E19° 46' 32.576"	N42° 23' 47.968"
T6	E19° 46' 33.289"	N42° 23' 47.559"
T7	E19° 46' 34.420"	N42° 23' 47.108"
T8	E19° 46' 35.294"	N42° 23' 46.684"
T9	E19° 46' 36.471"	N42° 23' 46.697"
T10	E19° 46' 39.805"	N42° 23' 45.577"
T11	E19° 46' 40.716"	N42° 23' 44.576"
T12	E19° 46' 42.323"	N42° 23' 42.213"
T13	E19° 46' 42.530"	N42° 23' 41.731"
T14	E19° 46' 43.575"	N42° 23' 39.887"
T15	E19° 46' 45.459"	N42° 23' 39.142"
T16	E19° 46' 47.564"	N42° 23' 35.037"
T17	E19° 46' 49.041"	N42° 23' 33.305"
T18	E19° 46' 49.600"	N42° 23' 32.422"
T19	E19° 46' 52.725"	N42° 23' 29.373"
T20	E19° 46' 53.480"	N42° 23' 27.529"
T21	E19° 46' 53.656"	N42° 23' 26.116"
T22	E19° 46' 56.082"	N42° 23' 23.920"
T23	E19° 46' 57.344"	N42° 23' 23.366"
T24	E19° 47' 0.400"	N42° 23' 22.476"
T25	E19° 47' 1.521"	N42° 23' 21.740"
T26	E19° 47' 2.213"	N42° 23' 20.531"
T27	E19° 47' 3.687"	N42° 23' 19.832"
T28	E19° 47' 4.615"	N42° 23' 19.722"
T29	E19° 47' 5.813"	N42° 23' 19.755"
T30	E19° 47' 6.564"	N42° 23' 19.643"
T31	E19° 47' 8.003"	N42° 23' 20.105"
T32	E19° 47' 10.645"	N42° 23' 19.605"
T33	E19° 47' 11.598"	N42° 23' 19.556"
T34	E19° 47' 12.327"	N42° 23' 19.426"
T35	E19° 47' 13.905"	N42° 23' 18.794"
T36	E19° 47' 14.746"	N42° 23' 18.665"
T37	E19° 47' 17.451"	N42° 23' 17.597"
T38	E19° 47' 17.480"	N42° 23' 17.059"
T39	E19° 47' 17.748"	N42° 23' 16.689"

T40	E19° 47' 17.990"	N42° 23' 15.673"
T41	E19° 47' 16.823"	N42° 23' 14.556"
T42	E19° 47' 16.406"	N42° 23' 13.871"
T43	E19° 47' 15.717"	N42° 23' 13.578"
T44	E19° 47' 15.397"	N42° 23' 13.171"
T45	E19° 47' 14.911"	N42° 23' 12.998"
T46	E19° 47' 14.472"	N42° 23' 12.162"
T47	E19° 47' 12.887"	N42° 23' 11.188"
T48	E19° 47' 11.583"	N42° 23' 10.249"
T49	E19° 47' 3.618"	N42° 23' 9.103"
T50	E19° 47' 2.639"	N42° 23' 8.556"
T51	E19° 47' 0.709"	N42° 23' 8.177"
T52	E19° 46' 59.652"	N42° 23' 7.205"
T53	E19° 46' 58.642"	N42° 23' 7.381"
T54	E19° 46' 58.164"	N42° 23' 7.711"
T55	E19° 46' 57.571"	N42° 23' 7.620"
T56	E19° 46' 55.212"	N42° 23' 8.187"
T57	E19° 46' 54.440"	N42° 23' 8.078"
T58	E19° 46' 48.737"	N42° 23' 6.797"
T59	E19° 46' 42.179"	N42° 23' 5.769"
T60	E19° 46' 40.282"	N42° 23' 8.961"
T61	E19° 46' 39.952"	N42° 23' 20.517"
T62	E19° 46' 35.141"	N42° 23' 31.771"
T63	E19° 46' 28.627"	N42° 23' 37.496"
T64	E19° 46' 27.172"	N42° 23' 39.878"
T65	E19° 46' 25.863"	N42° 23' 40.910"
T66	E19° 46' 23.410"	N42° 23' 41.291"
T67	E19° 46' 23.236"	N42° 23' 41.520"
T68	E19° 46' 23.225"	N42° 23' 42.100"
T69	E19° 46' 24.493"	N42° 23' 43.639"
T70	E19° 46' 24.637"	N42° 23' 44.178"
T71	E19° 46' 25.323"	N42° 23' 44.328"
T72	E19° 46' 26.449"	N42° 23' 45.522"
T73	E19° 46' 27.202"	N42° 23' 46.491"
T74	E19° 46' 27.197"	N42° 23' 46.663"
T75	E19° 46' 27.700"	N42° 23' 47.396"



TABELA II
KOORDINATAT GJEOGRAFIKE NË ZONËN E MBROJTUR TË FSHATIT THETH

Zona e Mbrojtur		
UTM Z 34N		
Emërtimi	Long.	Lat.
1	E19° 45' 49.296"	N42° 24' 35.253"
2	E19° 45' 51.725"	N42° 24' 36.102"
3	E19° 45' 51.425"	N42° 24' 36.460"
4	E19° 45' 53.142"	N42° 24' 37.779"
5	E19° 45' 53.056"	N42° 24' 38.396"
6	E19° 45' 53.331"	N42° 24' 38.610"
7	E19° 45' 54.541"	N42° 24' 37.779"
8	E19° 46' 0.523"	N42° 24' 36.643"
9	E19° 46' 1.372"	N42° 24' 36.956"
10	E19° 46' 2.476"	N42° 24' 36.870"
11	E19° 46' 4.913"	N42° 24' 37.468"
12	E19° 46' 8.862"	N42° 24' 38.263"
13	E19° 46' 11.757"	N42° 24' 35.308"
14	E19° 46' 11.834"	N42° 24' 34.012"
15	E19° 46' 11.351"	N42° 24' 33.792"
16	E19° 46' 11.610"	N42° 24' 33.006"
17	E19° 46' 10.008"	N42° 24' 32.283"
18	E19° 46' 11.489"	N42° 24' 31.129"
19	E19° 46' 10.486"	N42° 24' 30.230"
20	E19° 46' 11.707"	N42° 24' 27.829"
21	E19° 46' 9.377"	N42° 24' 24.668"
22	E19° 46' 11.136"	N42° 24' 23.727"
23	E19° 46' 14.174"	N42° 24' 20.503"
24	E19° 46' 18.002"	N42° 24' 20.949"
25	E19° 46' 22.040"	N42° 24' 19.794"
26	E19° 46' 23.478"	N42° 24' 17.195"
27	E19° 46' 25.064"	N42° 24' 14.785"
28	E19° 46' 25.847"	N42° 24' 13.945"
29	E19° 46' 26.646"	N42° 24' 14.145"
30	E19° 46' 27.901"	N42° 24' 14.856"
31	E19° 46' 28.472"	N42° 24' 15.031"
32	E19° 46' 28.963"	N42° 24' 14.707"
33	E19° 46' 32.368"	N42° 24' 12.986"
34	E19° 46' 33.708"	N42° 24' 13.517"
35	E19° 46' 35.378"	N42° 24' 11.879"
36	E19° 46' 41.437"	N42° 24' 10.546"
37	E19° 46' 42.930"	N42° 24' 9.561"
38	E19° 46' 45.036"	N42° 24' 6.265"
39	E19° 46' 46.078"	N42° 24' 5.441"
40	E19° 46' 46.949"	N42° 24' 5.001"
41	E19° 46' 47.252"	N42° 24' 4.124"
42	E19° 46' 48.374"	N42° 24' 1.940"

43	E19° 46' 49.824"	N42° 24' 1.028"
44	E19° 46' 50.628"	N42° 24' 0.170"
45	E19° 46' 50.642"	N42° 23' 59.447"
46	E19° 46' 51.365"	N42° 23' 58.533"
47	E19° 46' 49.256"	N42° 23' 54.626"
48	E19° 46' 50.538"	N42° 23' 53.902"
49	E19° 46' 58.736"	N42° 23' 45.977"
50	E19° 47' 0.870"	N42° 23' 40.592"
51	E19° 47' 4.778"	N42° 23' 34.959"
52	E19° 47' 17.752"	N42° 23' 27.635"
53	E19° 47' 19.987"	N42° 23' 22.596"
54	E19° 47' 29.181"	N42° 23' 22.444"
55	E19° 47' 32.269"	N42° 23' 11.959"
56	E19° 47' 12.176"	N42° 23' 6.759"
57	E19° 47' 0.514"	N42° 23' 2.910"
58	E19° 46' 45.478"	N42° 23' 0.219"
59	E19° 46' 33.855"	N42° 23' 4.661"
60	E19° 46' 23.535"	N42° 23' 23.861"
61	E19° 46' 19.345"	N42° 23' 26.360"
62	E19° 46' 12.246"	N42° 23' 27.376"
63	E19° 45' 54.817"	N42° 23' 28.718"
64	E19° 45' 42.528"	N42° 23' 38.631"
65	E19° 45' 40.548"	N42° 23' 49.312"
66	E19° 45' 33.101"	N42° 23' 59.330"
67	E19° 45' 30.297"	N42° 24' 1.438"
68	E19° 45' 28.961"	N42° 24' 3.194"
69	E19° 45' 28.368"	N42° 24' 5.997"
70	E19° 45' 28.873"	N42° 24' 8.383"
71	E19° 45' 28.128"	N42° 24' 11.765"
72	E19° 45' 26.251"	N42° 24' 13.179"
73	E19° 45' 22.724"	N42° 24' 16.819"
74	E19° 45' 22.074"	N42° 24' 20.069"
75	E19° 45' 23.202"	N42° 24' 21.325"
76	E19° 45' 24.317"	N42° 24' 23.003"
77	E19° 45' 25.648"	N42° 24' 23.784"
78	E19° 45' 25.945"	N42° 24' 25.475"
79	E19° 45' 26.355"	N42° 24' 26.387"
80	E19° 45' 26.318"	N42° 24' 27.137"
81	E19° 45' 36.199"	N42° 24' 30.473"
82	E19° 45' 37.426"	N42° 24' 32.266"
83	E19° 45' 38.103"	N42° 24' 32.864"
84	E19° 45' 43.315"	N42° 24' 34.384"



RREGULLORE
PËR ADMINISTRIMIN E QENDRËS
HISTORIKE TË FSHATIT THETH,
SHKODËR E TË ZONËS SË MBROJTUR
PËRRETH SAJ

Neni 1

Qëllimi dhe objektivat

1. Kjo rregullore përcakton detyrimet dhe mënyrat për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e vlerave historiko-kulturore të Qendrës Historike të fshatit Theth, Shkodër e të Zonës së Mbrojtur përreth saj.

2. Objektivat kryesorë të kësaj rregulloreje janë si më poshtë vijojnë:

a) Administrimi i Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur të fshatit Theth, sipas hartës së zonifikimit që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje, si pjesë integrale e saj; Mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave historiko-kulturore të Qendrës Historike të fshatit Theth;

b) Kjo rregullore përcakton mënyrat e bashkëpunimit me njësinë e qeverisjes vendore, Bashkinë Shkodër, për administrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të Qendrës Historike të fshatit Theth.

Neni 2

Kjo rregullore është në përputhje me Kushtetutën, ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe vendimin nr. 426, datë 13.7.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kartës shqiptare të restaurimit”, marrëveshjeve dhe dokumenteve të tjera në fushën e trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, të ratifikuara sipas legjislacionit shqiptar.

Neni 3

Hapësira urbane në mbrojtje

1. Hapësira urbane në mbrojtje e fshatit Theth përbëhet nga:

- a) Qendra Historike e fshatit Theth;
- b) Zona e Mbrojtur.

2. Kufijtë e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur paraqiten në hartën e zonifikimit të fshatit Theth, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

3. Plani i Përgjithshëm Vendor i qytetit të Shkodrës duhet të marrë parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes së Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur.

Neni 4

Qendra Historike dhe kufijtë e saj

1. Qendra Historike e fshatit Theth është pjesa me vlera urbanistiko-arkitektonike e fshatit dhe hapësira që mbart vlera të rëndësishme historike, që dokumenton rrugën e zhvillimit historik të fshatit drejt krijimit të një qendre të banuar dhe tiparet urbanistiko-arkitektonike, që u formuan gjatë historisë së tij. Hapësira urbane e fshatit, kryesisht, ruan ndërtime të vjetra me vlera arkitektonike e konstruktive dhe rrjetin rrugor ekzistues. Këto ndërtime janë të lidhura me mjedisin tradicional, i cili është pjesë e Qendrës Historike. Brenda kësaj qendre përfshihen objekte monument kulture të kategorisë së parë, si Banesa e Lulash Kecit (Muzeu Etnografik i Dukagjinit), Kulla e Nikoll Zef Koçekut (Kulla e ngujimit) etj.

2. Kufijtë e Qendrës Historike të fshatit Theth paraqiten me koordinata gjeografike në tabelën 1, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 5

Zona e Mbrojtur dhe kufijtë e saj

1. Zona e Mbrojtur shtrihet përreth Qendrës Historike. Ajo mbron vlerat e Qendrës Historike dhe krijon një kalim të butë drejt pjesës tjetër të fshatit, duke përfshirë disa lagje banimi më të veçuara në veri të Qendrës Historike.

2. Kufijtë e Zonës së Mbrojtur të Qendrës Historike të fshatit Theth paraqiten me koordinata gjeografike në tabelën 2, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 6

Klasifikimi i objekteve brenda Qendrës Historike

1. Brenda Qendrës Historike të fshatit Theth përcaktohen ndërtimet që shpallen monumente kulture, të cilat, sipas vlerave të tyre arkitektonike, ndahen në dy kategori: monumente të kategorisë së parë dhe monumente të kategorisë së dytë. Kjo ndarje sipas vlerave pasqyrohet në shkallën e ruajtjes së tyre, si dhe në mënyrat dhe shkallën e ndërhyrjes konservuese dhe restauruese.



2. Monumentet e kategorisë së parë janë shembujt me vlera të rëndësishme tipologjike dhe arkitektonike, që pasqyrojnë zhvillimin tipologjik dhe karakteristikat arkitektoniko-teknike të ndërtimeve të Qendrës Historike.

3. Monumentet e kategorisë së dytë janë ndërtime me vlera arkitektonike dhe historiko-kulturore, kryesisht si formuese të ansambleve urbanistiko-arkitekture, që marrin pjesë në formulimin kompozicional të fshatit, por dhe ruajnë vlera arkitekture në vetvete.

Neni 7

Ndërhyrjet në Qendrën Historike

Ndërhyrjet restauruese dhe rijetëzuese në Qendrën Historike do të kenë si qëllim mbrojtjen e vlerave arkitektonike të trashëgimisë kulturore të fshatit Theth. Për këtë qëllim, në Qendrën Historike kryhen studime për mënyrën e ndërhyrjeve restauruese dhe rijetëzuese në ndërtimet që e përbëjnë, si dhe për rehabilitimin e zonave të veçanta të saj. Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko-arkitekture të Qendrës Historike të fshatit Theth, brenda kësaj zone kryen këto ndërhyrje:

1. Ndërhyrje sistematike konservuese, restauruese dhe të mirëmbajtjes në Qendrën Historike, si dhe në monumentet e të dyja kategorive, bazuar në kriteret për konservimin dhe restaurimin.

2. Ndërhyrjet restauruese që synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistiko-arkitekture, rrjetit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, si dhe duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e sipërfaqes së hapësirave pushuese dhe të bimësisë tradicionale.

3. Ndërhyrjet bazuar në studimet për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të Qendrës Historike, që me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor dëmtojnë vlerat dhe unitetin kompozicional të Qendrës Historike, mund të kryhen në:

a) objektet ku kryhen punime konservuese dhe restauruese;

b) objektet ku kryhen ritrajtime për të rritur vlerat e tyre;

c) objektet në gjendje rrënoje ose të papërshtatshme për funksionim dhe që cenojnë unitetin arkitekturor të Qendrës Historike;

ç) zonat ku lejohet të kryhen rikonstruksione;

d) zonat ku lejohet të kryhen ndërhyrje integrale;

dh) parcelat e gjelbëruara.

4. Ritrajtimet dhe rikonstruksionet e përmendura në pikën 3 duhet të integrohen në tërësinë arkitekturore të Qendrës Historike, duke respektuar kompozimet dhe trajtimet e pamjeve të jashtme të ndërtimeve të vëna në mbrojtje dhe duke mos tejkaluar lartësinë maksimale të tyre.

5. Rikonstruksion mbi strukturat ekzistuese mund të kryhet: në rastet e fatkeqësive natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimt, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.

6. Ruhet rrjeti rrugor në kompozimin dhe formulimin e tij urbanistiko-arkitektonik.

Neni 8

Ndërhyrjet në monumente

1. Ndërhyrjet në monumentet e kategorisë së parë ruhen në tërësinë e kompozimit dhe teknikat origjinale, si në brendësi, ashtu edhe në pamjet e jashtme. Në rastet kur një pjesë e monumentit ka pësuar dëmtime, transformime ose mungon, mund të ndërmerren ndërhyrje plotësuese sipas gjendjes fillestare.

2. Ndërhyrjet në monumentet e kategorisë së dytë ruajnë volumin fillestar dhe formulimin e pamjes së jashtme, ndërsa në brendësi mund të bëhen ndryshime duke zbatuar kompozime sipas kërkesave të kohës dhe teknikat e sotme.

3. Në raste kur brenda monumenteve të kategorisë së dytë ruhen ambiente karakteristike, si gdhendje në dru, punime në allçi, dekorime pikturale ose mobilie arkitektonike me vlerë, këto të fundit ruhen dhe i nënshtrohen restaurimit, duke përfshirë materialet dhe teknikat tradicionale.

Neni 9

Ndërhyrjet e lejuara dhe ato që nuk lejohen në Zonën e Mbrojtur

1. Në këtë zonë kryhen restaurime, përshtatje, rikonstruksione apo edhe ndërtime të reja për të rritur vlerat e saj, të cilat duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të Qendrës Historike.



2. Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t'i përshtatet karakterit arkitektonik të ndërtimeve të Qendrës Historike, duke përdorur stilizime të elementeve morfologjike të tyre, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave etj.

3. Në zonat e gjelbra brenda Zonës së Mbrojtur bëhet ruajtja dhe përfshirja e vlerave mjedisore, duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e sipërfaqes dhe llojshmërinë e drurëve dhe bimësinë tradicionale.

4. Këto hapësira janë pjesë përbërëse e Zonës së Mbrojtur, kanë destinacion publik dhe janë elemente që i shërbejnë pamjeve panoramike të Qendrës Historike. Hapësirat ekzistuese të gjelbëruara ruhen si të tilla.

5. Në këto zona lejohen ndërhyrje për rehabilitimin e sipërfaqeve të gjelbëruara ekzistuese nëpërmjet të cilave mund të rriten vlerat e tyre. Në këto zona lejohet mbjellja e pemëve, punimet sistemuese, rregulluese dhe realizimet e rrugicave të brendshme me karakteristika dhe materiale tradicionale, që përshtaten me ato të cilat do të përdoren vetëm për këmbësorë.

6. Në zonat e gjelbra të veçanta të Zonës së Mbrojtur lejohen ndërtime të reja, si dhe ngritja e strukturave të elementeve të arredimit urban ose ato të shërbimit mbas studimeve të plota dhe të detajuara të këtyre zonave, në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor.

7. Drurët dhe gjelbërimi tradicional i rrugëve e shesheve ruhen dhe, pas degradimit, ripërtërihen me të njëjtat lloje.

8. Ndërhyrjet në rikonstruksionin e rrjetit rrugor dhe në sheshe duhet të kryhen me materiale dhe teknika që përshtaten me ato tradicionale.

9. Në këtë zonë kryhen restaurime, përshtatje, rikonstruksione apo dhe ndërtime të reja për të rritur vlerat brenda saj dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, të cilat duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të Zonës së Mbrojtur.

10. Lartësia maksimale e ndërtimeve të reja apo e rikonstruksioneve dhe përshtatjeve nuk duhet t'i kalojë 2 kate + çati të shfrytëzueshme, sipas tipologjisë karakteristike të ndërtimeve të kësaj zone. Në rastet kur për këto zona hartohen studime të veçanta, kushtet e zhvillimit përcaktohen nga këto studime.

11. Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t'i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të

arkitekturës tradicionale, duke përdorur stilizime të elementeve morfologjike të saj, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave etj.

12. Lejohet rikonstruksioni i rrjetit rrugor dhe i shesheve për përmirësimin e kushteve të infrastrukturës apo për përmirësimin ose realizimin e linjave të reja të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore, duke përdorur materiale, forma dhe teknika tradicionale. Ndërhyrje për modifikimin e gjurmës rrugore, e lidhur me nevojat për funksionim dhe përdorim sa më të mirë të zonës brenda së cilës ndodhet rruga.

13. Në rastet kur gjurma e rrugës në të cilën ndërhyhet shtrihet në disa zona, ndërhyrja i nënshtrohet kritereve të zonës me mbrojtje më të lartë.

Neni 10

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në Qendrën Historike dhe në monumente të veçanta

1. Projektet e restaurimit dhe restaurimi i monumenteve të kulturës hartohen nga institucione shtetërore të specializuara dhe nga subjekte të licencuara për këtë qëllim.

Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit.

2. Zbatimi i punimeve të mësipërme kryhet nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Shkodër ose nga subjektet e licencuara për restaurim. Mbikëqyrësi i punimeve dhe kolaudatori caktohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

3. Studimet dhe projektet e rikonstruksioneve hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Shkodër ose nga persona të licencuar në fushën e restaurimeve për këtë kategori projektesh.

Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit të ndjekë përcaktimet e legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

4. Studimet dhe projektet për ndërhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore hartohen nga subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë e mësipërme për fushat përkatëse, përfshirë edhe atë të restaurimit.



Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit të ndjekë përcaktimet e legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Neni 11

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në Zonën e Mbrojtur

1. Studimet për rehabilitimin e imazhit të Zonës së Mbrojtur hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, ose nga subjekte të licencuara në fushën e restaurimeve, sipas rregullores së miratuar. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit të ndjekë përcaktimet e legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

2. Projektet e rikonstruksionit të ndërtesave në këtë zonë hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë e mësipërme, për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit të ndjekë përcaktimet e legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

3. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet nga subjekte ndërtimore që janë të licencuara për këtë kategori.

4. Projektet për ndërtimet e reja në këtë zonë hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit të ndjekë përcaktimet e legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

5. Projektet e rikonstruksionit të rrugëve, shesheve dhe infrastrukturës së tyre hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë përkatëse në fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit të ndjekë përcaktimet e legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Neni 12

Shfrytëzimi i monumenteve

1. Monumentet e kulturës janë pjesë e jetesës së fshatit. Ato shfrytëzohen, sipas rastit, për funksionet për të cilat janë ndërtuar apo edhe për funksione të tjera, me kusht që këto funksione të mos cenojnë vlerat për të cilat monumenti është vënë në mbrojtje.

2. Mënyrat e përdorimit përcaktohen në ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar. Shfrytëzimi i monumenteve të kulturës për funksione të ndryshme prej atyre për të cilat janë ndërtuar, bëhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR).

Neni 13

Mbrojtja e monumenteve

1. Bashkia Shkodër, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e monumenteve të ngritura në hapësirat e juridiksionit të tyre.

2. Gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit, Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, duhet të respektohen dhe të merren parasysh vlerat e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur përreth saj.

Neni 14

Komiteti mbikëqyrës i Qendrës Historike

1. Për të ndihmuar dhe mbikëqyrur veprimtarinë dhe vlerësimin e Qendrës Historike dhe monumenteve të kulturës në fshatin Theth, pranë Bashkisë së qytetit Shkodër ngrihet Komiteti Mbikëqyrës i Qendrës Historike.

2. Ky komitet është një strukturë këshillimore dhe jovendimmarrëse, i cili përbëhet nga 5 anëtarë. Kryetari i këtij komiteti caktohet nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore të bashkisë dhe ka në përbërje të tij përfaqësues të institucioneve shtetërore të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore, të shoqatës së arkitektëve të qytetit, të përfaqësuesve të pronarëve dhe përdoruesve të ndërtimeve të Qendrës Historike, si dhe të organizmave joshetërorë, që ushtrojnë veprimtari për mbrojtjen e vlerave historiko-kulturore të bashkisë.

3. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të këtij komiteti përcaktohet në rregulloren e



funksionimit të brendshëm, që miratohet me 50 % + 1 të votave të të gjithë anëtarëve.

Neni 15

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe, për pasojë, nuk zgjidhen në këtë rregullore, sipas kompetencave, ato zgjidhen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Ministria e Kulturës.

Neni 16

Kundërvajtjet administrative

Çdo person fizik apo juridik, i cili kryen shkelje të kësaj rregulloreje, do të ngarkohet me përgjegjësi sipas dispozitave të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 17

Dispozita të fundit

1. Kjo rregullore shoqërohet me hartën përkatëse të Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur të fshatit Theth.

2. Brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi e kësaj rregulloreje, Instituti i Monumenteve të Kulturës, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Shkodër, i paraqet për shqyrtim dhe miratim ministrit përgjegjës për trashëgiminë listën e monumenteve të kulturës të kategorive I dhe II.

VENDIM

Nr. 734, datë 8.12.2017

PËR SHPALLJEN E LIQENEVE TË PRESPËS SI ZONË BASHKËMENAXHUESE PESHKIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 54 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e liqeneve të Prespës zonë bashkëmenaxhuese peshkimi, si objekte ujore me interes për peshkimin.

2. Plani i bashkëmenaxhimit për liqenet e Prespës miratohet me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, brenda 12 muajve nga data e miratimit të kësaj zone.

3. Masat menaxhuese të peshkimit të përpunohen me statusin mjedisor të zonës. Veprimtaritë që do të kryhen në liqenet e Prespës të jenë në përpunje me legjislacionin në fuqi për zonat e mbrojtura dhe me objektivat e planit të menaxhimit të parkut kombëtar Prespë, Korçë.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 735, datë 8.12.2017

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT NGA KATEGORIA E RESURISIT “TOKË BUJQËSORE” NË “TOKË URBANE” TRUALL, TË PASURISË ME NR. 61/6/6, ZONA KADASTRALE 1503, BASHKIA TROPOJË, TË PASURISË ME NR. 886, ZONA KADASTRALE 1402, BASHKIA DIBËR, TË PASURISË ME NR. 792, ZONA KADASTRALE 3509, BASHKIA DIBËR, TË PASURIVE ME NR. 36 DHE 66, ZONA KADASTRALE 2640, BASHKIA DIBËR, TË PASURISË ME NR. 157/13, ZONA KADASTRALE 2302, BASHKIA SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.03.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane” truall, të pasurisë me nr. 61/6/6, zona kadastrale 1503, Bashkia Tropojë, të pasurisë me nr. 886, zona kadastrale 1402, Bashkia Dibër, të pasurisë me nr. 792, zona kadastrale 3509, Bashkia Dibër, të pasurive me nr. 36 dhe 66, zona



kadastrale 2640, Bashkia Dibër, të pasurisë me nr. 157/13, zona kadastrale 2302, Bashkia Shkodër, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, në qarqet Kukës, Dibër dhe Shkodër, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane” truall, të pasurisë me nr. 61/6/6, zona kadastrale 1503, Bashkia Tropojë, të pasurisë me nr. 886, zona kadastrale 1402, Bashkia Dibër, të pasurisë me nr. 792, zona kadastrale 3509, Bashkia Dibër, të pasurive me nr. 36 dhe 66, zona

Lidhja nr. 1

Nr. rendor	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sip. m ²	Vendndodhja	Bashkia	Pronësia	Lëshuar certifikata
1	61/6/6	1503	2500	Domjan	Tropojë	Valter Milushi	ZVRPP Tropojë
2	886	1402	1125	Çidhen	Dibër	Basri Cami	ZVRPP Dibër
3	792	3509	8560	Staravec	Dibër	Sali Vrenezi	ZVRPP Dibër
4	36	2640	640	Melan	Dibër	Shemsi Ngota	ZVRPP Dibër
5	66	2640	300	Melan	Dibër	Shemsi Ngota	ZVRPP Dibër
6	157/13	2302	10000	Shkodër	Shkodër	Ndriçim Gjoni	ZVRPP Shkodër

VENDIM

Nr. 736, datë 8.12.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 113, DATË 17.2.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, PËRBËRJEN DHE PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KOMITETIT NDËRSEKTORIAL PËR MBROJTJEN NGA PRODUKTET E DUHANIT (KNMSHPD)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 113, datë 17.2.2007, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|---------|
| a) Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë | anëtar; |
| b) Zëvendësministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë | anëtar; |
| c) Zëvendësministri i Brendshëm | anëtar; |

kadastrale 2640, Bashkia Dibër, të pasurisë me nr. 157/13, zona kadastrale 2302, Bashkia Shkodër.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Kukës, Këshilli i Qarkut Dibër, Këshilli i Qarkut Shkodër, Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tropojë, Dibër dhe Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

- d) Kryetari i Këshillit Kombëtar i Radios dhe Televizionit Publik Shqiptar anëtar;
- ç) Zëvendësministri i Turizmit dhe Mjedisit anëtar;
- dh) Drejtori i Institutit të Shëndetit Publik anëtar;
- e) Kryeinspektori Sanitar Shtetëror anëtar;
- ë) Drejtori i Policisë Bashkiake Tiranë anëtar;

“1. Ngritjen e Komitetit Ndërsektorial për Mbrojtjen nga Produktet e Duhanit (KNMSHPD), me kryetar ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe me këtë përbërje:

Funksionet e sekretarit të KNMSHPD-së të kryhen nga Drejtori i Institutit të Shëndetit Publik.”.

2. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Shpërblimi për pjesëmarrësit, për çdo mbledhje, bëhet sipas vendimit nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.”.

3. Në pikën 7 dhe në të gjithë përmbajtjen e këtij vendimi, emërtimi “Ministri i Shëndetësisë” zëvendësohet me “Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja KRISTALINA
Tiranë, 2017

Çmimi 280 lekë